



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

Tema:

“ZGJIDHJA E KONTESTEVE INVESTUESE NË TË DREJTËN KOMPARATIVE DHE REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT”

Kandidatja
Ardita Ilazi

Mentor
Prof. dr Adnan Jashari

Tetovë, Tetor, 2020

Përmbajtja

HYRJE	4
<u>KREU I: NË PËRGJITHËSI MBI KONTESTET INVESTUESE</u>	
1.Kuptimi Investimeve të huaja	7
2.Llojet e investimeve të huaja	7
2.1.Investimet e huaja	7
2.2.Investimet e huaja direkte	7
3.Mbrojtja juridike e Investimeve të huaja direkte	8
3.1.Mbrojtja në baze të marrveshjeve ndërkombëtare	9
3.2.Mbrojtja në bazë të mekanizmave privat juridike	12
<u>KREU II: ZGJIDHJA E KONTESTEVE INVESTUESE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT</u>	
1. Mediacioni	14
2. Arbitrazhi	17
2.1.Arbitrazhi i përkohshëm	18
2.2.Arbitrazhi institucional	18
3.Zgjidhja e kontesteve nga gjykatat në Maqedoninë e Veriut	19
3.1. Inicimi i procedurës	20
3.2. Gjykatat kompetente	21
<u>KREU III: ZGJIDHJA E KONTESTEVE INVESTUESE NË TË DREJTËN KOMPARATIVE</u>	
1.MIGGA	38
1.1.Themelimi	39
1.2. Inicimi i procedurës	40
1.3.Zhvillimi dhe përfundimi i procedurës	41
2.ICSID	43
2.1.Themelimi	44
2.2. Inicimi i procedurës	45
2.3.Zhvillimi dhe përfundimi i procedurës	47
3.Arbitrazhi ndërkombëtar	48
3.1.Themelimi	49
3.2. Inicimi i procedurës	50
3.3. Zhvillimi dhe përfundimi i procedurës	51

KREU IV: TË DHËNA STATISTIKORE DHE RASTE NGA PRAKTIKA NË LIDHJE ME ZGJIDHJEN E KONTESTEVE INVESTUESE

Përfundime dhe Rekomandime.....66

Literatura.....68

HYRJE

Suksesi i një shteti, padyshim janë edhe investimet që kryhen në të. Por jo vetëm kaq, investimet janë sukses i një individi, i një kompanie dhe i një shteti të huaj, kur kemi të bëjmë me investime të huaja. Por, si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve nga ana e investorëve apo shkeljeve të marrëveshjeve me të cilat mbrohen ato investime, krijohen edhe vetë kontestet. Atëherë vjen në shprehje mënyra për zgjidhjen e tyre, çështje tjetër me rëndësi është shqyrtimi i mënyrave për zgjidhjen e kontesteve, që natyrisht është e nevojshme që t’i jepet përparësi mënyrës më të shpejt dhe efikase. Pikërisht, ky hulumtim përvijon mënyrat e zgjidhjes së kontesteve, ku vëmendje e veçantë ju kushtohet zgjidhjes së kontesteve nëpërmjet mënyrave paqësore, mediacionit si dhe arbitrazhit. Mediacioni konsiderohet negociim i lehtësuar nga një palë e tretë, neutrale. Arbitrazhi konsiderohet mënyrë e shpejtë e zgjidhjes së kontesteve, ekonomik dhe mjaft i ndërgjegjshëm. Nëpërmjet së cilës palët në kontest kanë mundësi që të zgjedhin, që për kontestin e tyre të vendos një ose më tepër arbitra, të cilët në mënyrën më të mirë të mundshme do të zgjidhin kontestin e tyre. Fokusi i punimit do të jetë Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve - ICSID dhe Agjensioni Multirateral për Sigurimin e Investimeve - MIGA, të cilat vijnë në shprehje për mbrojtjen dhe sigurinë e investimeve të huaja në mbarë botën. Gjithashtu, në punim do të flitet edhe për zgjidhjen e kontesteve nëpërmjet rrugës gjyqësore. Kompetente për zgjidhjen e kontesteve investuese është gjykata themelore. Me fjalë të tjera, qëllimi i hulumtimit është të japë një përshkrim të hollësishëm mbi investimet e huaja në aspekt juridik. Të identifikojë dhe të analizojë mënyrat e zgjidhjes së kontesteve, të analizojë nëse zgjidhja e kontesteve nga ana e arbitrazhit është zgjidhje më efikase, të nxjerr në pah rolin dhe rëndësinë e mediacionit, i cili shumë pak është i njohur në vendin tonë, e aq më pak vjen në shprehje nga palët në kontest, edhe pse mediacioni është një nga mënyrat më të lira, ku vjen në shprehje vetë vullneti i palëve që të vendosin se si do të ishte më e përshtatshme për to, nga ana tjetër me zgjidhjen e kontesteve nga ana e gjykatës, është gjykata ajo që vendos për palët. Pra, ky hulumtim do të paraqesë në vete edhe një gërshetim në mes mënyrave të zgjidhjes së kontesteve duke i shqyrtuar avantazhet dhe dizavantazhet e tyre. Pyetjet hulumtuese do të jenë:

- ❖ *Cila është mënyra e duhur për zgjidhjen e kontesteve investuese dhe duhet të jetë prioritet për palët në kontest?*

- ❖ *Cilat janë avantazhet e arbitrazhit kundrejt mënyrës gjyqësore për zgjidhje të kontesteve?*
- ❖ *A është kuadri ligjor mbi investimet i pavarur, mirëfunksionues dhe në pajtueshmëri me standardet evropiane dhe ndërkombëtare?*
- ❖ *A parashikon kuadri ligjor trajtimin e njëjtë të investitorëve të huaj dhe vendas?*

Do të hipotezojmë: Përshtatshmërinë e mekanizmave aktual ligjorë për zgjidhjen e kontesteve investuese në Maqedoninë e Veriut; Mediacioni, mekanizmi më i përshtatshëm për zgjidhjen e kontesteve investuese në Maqedoninë e Veriut; Rëndësinë dhe efikasitetin e arbitrazhit në zgjidhjen e kontesteve midis palëve në Maqedoninë e Veriut.

Punimin do t’a strukturojmë në këtë mënyrë, *së pari*, do të flasim për kuptimin mbi investimet e huaja, llojet e investimeve të huaja, mbrojtjen juridike të investimeve të huaja (nënçështjet: mbrojtja në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, mbrojtja në bazë të mekanizmave privat juridike). *Së dyti*, do të flasim për zgjidhjen e kontesteve investuese nëpërmjet mediacionit, arbitrazhit duke përfshirë atë të përkohshëm dhe atë institucional, zgjidhjen e kontesteve nga gjykatat në Maqedoninë e Veriut, iniciimi i procedurës, gjykatat kompetente. *Së treti*, do të flasim për zgjidhjen e kontesteve investuese në të drejtën komparative, nëpërmjet Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve - ICSID dhe Agjensionit Multilateral për Sigurimin e Investimeve – MIGA, gjithashtu do të përfshijmë arbitrazhin ndërkombëtar. Më tej, në kreun e katërt do të paraqesim të dhëna statistikore duke hulumtuar rastet nga praktika. Në përfundim të këtij punimi do të japim konkluzione dhe rekomandime se cila është mënyra e duhur, më efikase, më e shpejtë dhe natyrisht me kosto më të ulët për zgjidhjen e kontesteve investuese.

KREU I

1.NË PËRGJITHËSI MBI KONTESTET INVESTUESE

Kontestet kanë tendencën të krijojnë palën në rolin e protagonistit dhe antagonistit. Thënë ndryshe, viktimën nga njëra anë dhe nga ana tjetër kundërshtarin e viktimizimit. Gjykata ndërkombëtare e drejtësisë definon kontestin: *“Mosmarrëveshje mbi çështjet ligjore apo faktike, konflikt i pikëpamjeve juridike apo interesave juridike midis palëve”* si dhe *“Gjendje në të cilën të dyja palët kanë mendime kontradiktore mbi çështjen e pajtushmërisë midis tyre.”*¹ Gjithësesi, në këtë hulumtim ne do të konstatojm se investitorët janë mirë të informuar, për ndryshimet eventuale, që mund të paraqiten nga kontestet. Në fakt vetë investimet “parashikojnë” ndikimin politik, si në kohën e investimit ashtu edhe në të ardhmen e saj. Parashikim ky, që arrinë deri në atë masë sa që i lejon investitorët të ndërmarin stabilitetin dhe potencialin e duhur në zgjidhjen e një mjedisi sa më pozitiv për investime.

Ndërkaq, koncepti i një "investimi"² mund të përfshijë përdorimin e kapitalit, aftësive teknike dhe menaxheriale, patentave dhe pronave të tjera intelektuale, si dhe një shumëllojshmëri të pasurive të tjera, duke përfshirë aktivitetet siç janë: operacionet e minierave; ndërtimin dhe funksionimin e hoteleve; bankat; projektet e infrastrukturës; ofrimin e shërbimeve të ndryshme të inxhinierisë civile; projekt ndërtimet e ndryshme; aksionet; instrumentet financiare; përfshirë edhe vetë kreditë. E drejta për investime ndërkombëtare nuk bën dallim në përgjithësi midis investimeve, sipas kësaj të drejte një investim është një aktiv ose element i fituar me qëllim të gjenerimit të të ardhurave. Një investim ka të bëjë gjithmonë me shpenzimin e kohës, parasë ose përpjekjeve, për një fitim më të lartë në të ardhmen, si shembull për këtë mund të ilustrjmë:

Shembulli 1:

“Një investitor mund të blejë tani një aktiv monetar me idenë që aktivi do të sigurojë të

¹ R, Dolzer, Ch, Schreuer, *Principles of International Investment Law*. Oxford University Press, 2008.

² Në Fjalorin e Shqipes së Sotme (Botimet Toena, 2002). Termi “Investim” interpretohet si investimi i kapitalit, i fondeve, i shumave të mëdha, investime për industrinë, për mbrojtjen. Shumë parash a kapital që investohet për diçka. Investitor, ai që investon. Investohet, vë një shumë parash a një kapital në një ndërmarrje industriale, për të përdorur për ndërtime të ndryshme, për zhvillimin e ekonomisë, për rritjen e përtëritjen e mjeteve të prodhimit, për qëllime ushtarake etj.

ardhura, ose në të ardhmen do të shitet me një çmim më të lartë se sa që ishte blerë”

1.1.Kuptimi i Investimeve të huaja

Ashtu sikurse është zhvilluar globalizimi në ekonomi, tani është më së e zakonshme që kompanitë e mëdha të investojnë në vende të tjera. Globalizimi i referohet zgjerimit të pikëpamjes ndaj botës, si një hapësirë më e gjërë, e integruar, kulturore, shoqërore dhe ekonomike³. Kryesisht në shekullin e kaluar, kompanitë që kanë funksionuar dhe kishin një prezencë "lokale", tani janë zgjeruar në "gjigant ndërkombëtarë" që dominojnë botën. Prandaj, mund të themi se si rezultat i globalizimit bota po bëhet gjithnjë e më e vogël dhe falë kësaj, ne po jetojmë si një "fshat global"⁴. Si pasojë e globalizimit, të gjitha vendet konkurrojnë me njëri-tjetrin për të tërhequr vëmendje, respekt dhe besim të investitorëve⁵.

Atëherë kur investitori nga një shtet investon me aksionet e kompanisë së tij në një shtet tjetër konsiderohet investim i huaj. Atëherë kur investitori i huaj investon në vend të huaj dhe merr pjesë drejtëpërdrejtë me aksionet e tij konsiderohet investim i huaj direkt, për shembull:

Shembulli 2:

Atëherë kur kompania ka më së paku 10% të kapitalit aksionar me të drejtë vote në pronësi të investitorëve të huaj, kompania mund të klasifikohet si një investim i huaj direkt për vendin pritës, rezident i investitorit të huaj⁶.

Investimi mund të definohet secili kapital, mjet esencial apo aktiva e cila më pastaj do të kualifikohet si investim⁷. Gjithësesi, klima e investimeve është bërë e paparashikueshme dhe e rëndë, pasi që investitorët tani duhet të merren me ligjet dhe gjykatat ndërkombëtare, si dhe me standardet e modifikuara për mbrojtje të investimeve⁸.

³ R. Muçaj, *International Arbitration as a Prerequisite in Today's Global Economy*, 2015.

⁴ Q. Jija, *Our Global Village, Prospects for Globalization and National Borders*, 2011.

⁵ A. Ilazi, *Ndikimi i Imazhit të Shtetit në tërheqjen e investimeve të huaja*, Tetovë, 2017.

⁶ OECD, *Benchmark Definition of Foreign Direct Investment*, Fourth Edition, 2008

⁷ Z. Douglas, *The international Law of Investment Claims*, 2009.

⁸ M. A. Forere, *New Developments in International Investment*, 2018.

1.2.Llojet e investimeve të huaja

Në ndarjen më të zakonshme, për nga llojet investimet mund të klasifikohen në investime të huaja dhe investime të huaja direkte. Në vazhdim të hulumtimit do të flasim për secilën lloj në veçanti.

1.2.1.Investimet e huaja

Investitorët, investojnë me qëllimin për të realizuar objektivat e tyre të përcaktuara. Sipas profesorit Jashari “Investimet e huaja mund të përkufizohen si angazhim i mjeteve financiare, apo i të mirave të tjera materiale të shprehura financiarisht për realizimin e qëllimeve zhvillimore”⁹.

1.2.2.Investimet e huaja direkte

Investime e huaja direkte janë investime përmes së cilave investitori ka për qëllim të krijoj lidhje ekonomike të vazhdueshme, të realizojë të drejtë të udhëheqjes me shoqërinë tregtare ose person tjetër juridik në të cilin investon. Sipas *Ligjit për punë devizore*, investime direkte konsiderohen: “Themelimi i shoqërisë tregtare në pronësi të tërësishme të investitorit, themelimi i degës ose përvetësimi i pronësisë së tërësishme mbi shoqërinë tregtare ekzistuese; pjesëmarrja në shoqëri tregtare të sapoformuar ose veç më ekzistuese, nëse investitori me atë posedon ose pajiset me më shumë se 10% pjesëmarrje në kapitalin bazë të shoqërisë tregtare, përkatësisht më shumë se 10% nga e drejta për vendosje; hua afatgjate me periudhë të maturimit prej pesë dhe më shumë vjet, kur bëhet fjalë për hua nga investitor dhe e cila është e dedikuar për shoqërinë tregtare në pronësinë e tij të tërësishme dhe hua afatgjate me periudhë të maturimit prej pesë vjet dhe më shumë, kur bëhet fjalë për hua të dedikuar për krijimin e lidhjes ekonomike të përhershme dhe nëse është dhënë në mes subjekteve ekonomike të lidhura”¹⁰. “Investimet e huaja direkte janë investime të cilët investitori i huaj i investon në formë materiale, ose jo materiale në një afat të gjatë në shoqëritë dhe vendet

Joint ventures investime;
Koncesione;
Greenfield investime;
Akuizicionet.

⁹ A.Jashari, *E drejta afariste kontraktore*, Tetovë, 2016, fq 574.

¹⁰ Neni 2, *Ligji per Punë Devizore*, Gazeta Zyrtare nr.30/93.

e huaja, në bazë të së cilës siguron të drejtën që të udhëheq me shoqëritë ku ka investuar duke pasur kështu rol aktiv në punën e shoqërisë¹¹. Investimet e huaja direkte mund të paraqiten si:

-Joint ventures investime- që nënkupton sipërmarrje e përbashkët, e ndërmarrë bashkërisht nga dy ose më shumë palë të cilët ruajnë identitetet e tyre veçmas. Nga përkufizimi më klasik i investimeve *joint ventures* nënkuptojmë: Një marrëveshje bashkëpunimi në të cilën dy kompani bashkojnë projektet e tyre. Çelësi për këto investime është *bona fides*. Si shembuj të *joint venture* investimeve mund të përmendim:

Shembulli 3:

Korporata e teknologjisë Google dhe administrata kombëtare aeronautike hapësinore amerikane NASA në vitin 2015 firmosën marrëveshje për të kryer kërkime dhe zhvillime të nivelit të lartë, kështu duke krijuar Google Earth¹². Shembuj të tjerë që mund të përmendim janë: samsung dhe spotify, dy kompanit lidhën marrëveshje investimi duke e bërë më të lehtë përdorimin e shërbimit për të dëgjuar muzikë, spotify në pajisjet samsung; barnes & noble dhe starbucks, vendosja e kafesë starbucks në libraritë barnes & noble. Një nga marrëveshjet e investimeve joint ventures më të famshme ndër vite ishte edhe ajo ndërmjet sony ericsson, i cili ishte tepër i suksesshëm për më shumë se 10 vite përpara se sony të blinte ericsson. Nga shembulli i fundit vlen të theksojm se marrëveshjet joint ventures dështojn, atëherë kur kompania nuk respekton marrëveshjen bazë, që të siguroj vazhdimisht produkte më inovative, siç është arsyeja kryesore e dështimit të marrëveshjes joint ventures nga sony ericsson.

-Koncesionet- termi "*marrëveshje koncesioni*" referohet një lloji të kontratës së negociuar që i jep një kompanie të drejtën për të bërë investim, me disa kërkesa specifike. Në një kuptim tjetër koncesioni i referohet një marrëveshjeje në mes një kompanie të huaj dhe qeverisë, në të cilën kompania nënshkruan një marrëveshje koncesioni në mënyrë që të mund të investoj në shtetin e asaj qeverie. Kjo lloj marrëveshjeje është ajo që i jep koncesionarit të drejtën ekskluzive për të bërë investime në një zonë apo vend të caktuar në këmbim të kushteve të negociuara.

-Greenfield investime- investimet e “fushës së gjelbërt” janë një lloj investimi i huaj direkt, ku një kompani themelon filialin e saj në vend të huaj, e cila më parë nuk ka ekzistuar.

¹¹ A.Jashari, *Aspekti juridik i investimeve të huaja direkte në shtetet në tranzicion*, Tetovë, 2007, fq:13.

¹² BBC News, Retrieved 10 April 2019 from: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/business/4292458.stm> .

Është një formë e hyrjes në treg, si shembull për këtë mund të ilustron:

Shembulli 4:

Korporata automobilistike japoneze, Toyota Motor, njoftoi planet për greenfield investime në vitin 2019, me qëllimin për të krijuar një filial të ri prodhimi në Tijuana të Meksikës, përmes investimit prej rreth 1 miliard dollarë. Arsyeja e investimit greenfield nga Toyota, ishte që të përmirësojë konkurrencën në Amerikën e Veriut, veçanërisht brenda SHBA-ve¹³.

Gjithashtu investimet e huaja direkte mund të jenë të paraqitura në të holla, mjete, repromateriale dhe të drejta ¹⁴.

3.Mbrojtja juridike e Investimeve të huaja direkte

Çështje tjetër e rëndësishme për investimet e huaja është që të sigurojnë mbrojtje juridike. Mbrojtja e investimeve duhet të përfshijë mekanizma efikas të zbatimit. Për shkak të karakterit ndërkombëtar, investimet e huaja kanë rrezik edhe më të lartë sesa investimet e brendshme, Ligji mbi investimet e huaja luan një rol shumë të rëndësishëm për të mbrojtur investimet e huaja dhe investitorët e huaj në vendet nikoqire. Veçanërisht, nëse investitorët e huaj po zhvillojnë investimet e tyre në vendet nikoqire, dhe të cilat përballen me kombinime nga më të ndryshmet, siç mund të jenë: sistem i paqëndrueshëm politik, ekonomik; sistem joefektiv i administrimit, korrupsionit. Mbrojtja e investimeve të huaja direkte mund të bëhet me marrëveshje ndërkombëtare dhe me mekanizma privat juridik.

3.1.Mbrojtja në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare

Mbrojtjet për investitorët e huaj varen nga marrëveshjet e investimeve ndërkombëtare mbi të cilat investitorët mbështesin pretendimet e tyre. Mbrojtja ndërkombëtare e investimeve të huaja direkte mund të bëhet në bazë të: Marrëveshjeve bilaterale dhe Marrëveshjeve multilaterale.

Marrëveshjet bilaterale, motivet e palëve janë të kundërta, secila nga palët dëshiron që të realizojë qëllime të posaçme, kurse te marrëveshjet multilaterale, motivet dhe

¹³ Retrieved 10 April 2019 from: <https://corporatefinanceinstitute.com/resources/knowledge/strategy/greenfield-investment/> .

¹⁴ A.Jashari, *E drejta afariste kontraktore, Tetovë, 2016, fq 583.*

qëllimet e të gjitha palëve janë të njëjta, pasi që palët pretendojnë realizimin e një qëllimi ¹⁵. Marrëveshja bilaterale është traktati midis dy shteteve, që krijohet për të promovuar dhe mbrojtur reciprokisht investimet e bëra nga investorët e shtetit të origjinës në territorin e shtetit nikoqir. Marrëveshjet bilaterale ju japin investorëve të mbuluar një gamë të gjerë të të drejtave ligjore, që zakonisht zbatohen drejtpërdrejt kundër shtetit nikoqir përmes arbitrazhit ndërkombëtar. E rëndësishmja këtu është se investorët i gëzojnë këto të drejta, përfshirë të drejtën për t'i zbatuar ato, përmes arbitrazhit ndërkombëtar në formë neutrale, edhe nëse nuk janë palë në një kontratë me shtetin nikoqir¹⁶. Maqedonia e Veriut ka të nënshkruar marrëveshje për tërheqjen dhe mbrojtjen e Investimeve të Huaja Direkte me vendet e mëposhtme:

Shqipërinë, Austrinë, Bjellorusinë, Belgjikën, Bosnjën dhe Hercegovinën, Bullgarinë, Kinën, Kroacinë, Republikën Çeke, Egjiptin, Finlandën, Francën, Gjermaninë, Hungarinë , Indin, Iranin, Italin, Luksemburgun, Malajzin, Malin e Zi, Hollandën, Korejën e Veriut, Polonin, Rumanin, Rusinë, Serbinë, Sllovakin, Sllovenin, Spanjën, Suedin, Zvicrën, Tajvanin, Turqin dhe Ukrainën¹⁷.

Maqedonia e Veriut është nënshkruese e tre Marrëveshjeve bilaterale të tregtisë së lirë:

<i>Marrëveshja e Stabilizim Asociimit MSA</i>
<i>Marrëveshja Evropiane e Tregtisë së Lirë EFTA</i>
<i>Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore CEFTA</i>

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me vendet anëtare të BE-së, duke i dhënë Maqedonisë së Veriut akses pa taksa për 650 milion konsumatorë; Marrëveshja Evropiane e Tregtisë së Lirë, me Zvicrën, Norvegjinë, Islandën dhe Lihtenshtajnin; dhe Marrëveshja e

¹⁵ A.Jashari, *Aspekti juridik i investimeve të huaja direkte në shtetet në tranzicion, Tetovë, 2007, fq: 156, 157.*

¹⁶ Latham&Watkins, Retrieved 20 August 2019 from: <https://www.lw.com>.

¹⁷ Retrieved 10 Maj 2019 from: <https://investmentpolicy.unctad.org/international-investment-agreements/countries/124/north-macedonia>.

Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Moldavinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Kosovën. Marrëveshjet bilaterale të tregtisë së lirë janë në fuqi me Turqinë dhe Ukrainën¹⁸.

3.2.Mbrojtja në bazë të mekanizmave privat juridike

Sigurisht, investorët duan të sigurojnë që investimet e tyre t’u nënshtrohen rregullave të parashikueshme dhe të qëndrueshme si dhe të jenë të mbrojtura mirë. Mekanizmat privat që përdoren nga shtetet, shpesh janë që të sigurojnë mbrojtje për investimet e huaja përmes traktateve të njohura ndryshe si konventa apo marrëveshje dhe ligjislacioneve shtetase që rregullojnë çështje mbi investimet.

Shumë nga marrëveshjet investuese përmbajnë dispozita përmes së cilave garantojnë standard të plotë të mbrojtjes dhe sigurisë së investorëve dhe investimeve. Në fakt ky standard ka mundësi të paraqitet si detyrim për vendin investues, për të siguruar masat e nevojshme për mbrojtjen nga kërcënimet fizike ndaj investorëve. Pra, objektet e mbrojtjes mund të jenë investorët ose investimet. Sipas gjykatave të arbitrazhit: *“Masat që prekin personalisht një investor pa ndonjë efekt shoqërues në investim nuk përbëjnë shkelje të standardit të mbrojtjes”*. Sipas praktikës së arbitrazhit *“mbrojtja duhet të përfshijë edhe investorin në mënyrë implicite”*. Në qoftë se investitori përfshihet si objekt i mbrojtjes, atëherë përfshihet edhe çështja e kompensimit për sulmin fizik ndaj tij. Logjikisht lind pyetja: Çfarë lloj dëmi do të përbënte një sulm i tillë, dëm material apo vetëm dëm moral? Në bazë të Gjykatave të arbitrazhit dëmet morale nuk mund të pranohen për të vërtetuar dëmin material. Prandaj, investitori nuk do të kishte të drejtë për kompensim të dëmit moral si pasojë e një sulmi fizik nëse nuk do të mund të provonte edhe dëmin material që kishte pësuar. Sidoqoftë është ende e diskutueshme, nëse kompensimi mund të jepet vetëm për dëmin moral që investitori, si rregull, do të pësonte për shkak të sulmit fizik¹⁹.

¹⁸ Retrieved 10 Maj 2019 from: [North Macedonia | Investment Dispute Settlement Navigator | UNCTAD Investment Policy Hub](#).

¹⁹ O. Miljenić, *Full Protection and Security Standard in International Investment Law*, 2019.

KREU II

ZGJIDHJA E KONTESTEVE INVESTUESE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Sistemi juridik i Maqedonisë së Veriut bazohet në të drejtën civile. Kushtetuta e vendit parashikon gjykata të pavarura. Kuadri ligjor i Maqedonisë së Veriut për investitorët e huaj, është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, investitorët e huaj zakonisht trajtohen njësoj si investitorët vendas. Maqedonia e Veriut ka të thjeshtësuar rregulloret dhe procedurat për investitorët e huaj si dhe vazhdon të bëjë ndryshime²⁰ të tilla, si një vend kandidat për pranim në BE, gradualisht po harmonizon sistemin ligjor dhe rregullator me standardet e BE-së.

Maqedonia e Veriut është palë në *Konventën për Zgjidhjen e Kontesteve Investuese ndërmjet Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të tjera dhe Konventën Evropiane për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar*. Për më tepër, Maqedonia e Veriut është nënshkruese, e marrëveshjeve multilaterale dhe bilaterale mbi arbitrazhin, përfshirë:

- *Konventën e Nju Jorkut të vitit 1958 mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj;*
- *Konventa e Gjenevës për Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj;*
- *Protokolli i Gjenevës 1923 mbi nenet e Arbitrazhit;*
- *Agjensionin multilateral për sigurimin e investimeve*²¹.

Maqedonia e Veriut pranon procedurën e një arbitrazhi ndërkombëtar vetëm në kontestet me investitorët e huaj, atëherë kur paraqiten konteste *investitor - shtet*. Vendimet e arbitrazhit të huaj janë përgjithësisht të njohura dhe të zbatueshme në vend, në qoftë se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në Konventë dhe Ligjin për të drejtën

²⁰ Sidoqoftë, ajo që është shqetësuese janë pikërisht këto ndryshimet e shpeshta në rregulloret investuese, paqëndrueshmëria e tyre krijojnë një shtet të paparashikueshëm kështu duke lejuar edhe rritjen e korrupsionit. Transparency International e renditi Maqedoninë e Veriut në vendin e 93-të nga 180 vende në indeksin e saj të Perceptimit të Korrupsionit 2019, 14 pikë më shumë se në vitin 2018.

<https://www.transparency.org/en/cpi/2019/results/mkd>, Tetor 2019.

²¹ Investment climate statements, Retrieved 08 September 2020 from: <https://www.state.gov/reports/2020-investment-climate-statements/north-macedonia/>.

ndërkombëtare private. Gjykatat vendase njohin dhe zbatojnë vendimet e huaja të arbitrazhit të lëshuara kundër Maqedonisë së Veriut, pranojnë vendime ndërkombëtare të arbitrazhit për kontestet e investimeve si dhe aktgjykime të gjykatave të huaja. Ligji i vendit për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar është modeluar në Komisionin e Kombeve të Bashkuara për Ligjin Ndërkombëtar të Tregtisë – UNCITRAL si dhe Ligjin Model mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar²².

1. Mediacioni

Në Maqedoninë e Veriut mediacioni apo i njohur ndryshe si ndërmjetësimi rregullohet në kuadër të Ligjit për ndërmjetësim, sipas së cilës mediacioni është çdo ndërmjetësim, pa marrë parasysh emërtimin e tij, gjatë zgjidhjes së marrëdhënieve kontestuese në procedurë të mediacionit në të cilën palëve në marrëdhënie kontestuese u mundësohet që të njëjtin ta zgjidhin përmes negocimit, në mënyrë paqësore me ndihmën e një ose më shumë mediatorëve të licencuar, me qëllim që të arrihet zgjidhje e pranueshme dhe e përbashkët e shprehur në formë të marrëveshjes me shkrim²³. Mediacioni vepron në bazë të disa parimeve edhe atë: *parimi neutralitetit* - në procedurën e mediacionit, mediatori vepron në mënyrë neutrale dhe të paanshme në aspekt të palëve ose të marrëdhënies kontestuese²⁴; *parimi vullnetarizmit* -procedura e mediacionit zbatohet në bazë të pëlqimit strikt me shkrim të palëve, përveç në marrëdhënie kontestuese ku me ligj të veçantë fillimi i procedurës së ndërmjetësimit parashihet si kusht për mbajtjen e procedurës gjyqësore ose procedurës tjetër²⁵; *parimi besueshmërisë* - të gjitha informatat që dalin ose janë të lidhura me procedurën e mediacionit do të mbeten të besueshme, përveç nëse palët nuk merren vesh me shkrim ndryshe²⁶; *parimi efikasitetit*-procedura e mediacionit është procedurë ekonomike, efikase dhe e shpejtë deri te e cila palët kanë qasje të lehtë dhe të barabartë²⁷; *parimi drejtësisë* - në procedurën e mediacionit garantohet veprimi i drejtë. Palët duhet të nxiten nga mediatori, që plotësisht të bashkëpunojnë në procedurë dhe të

²² Retrieved 26 Gusht 2019 from: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/694861555898490178/pdf/North-Macedonia-Country-Partnership-Framework-for-the-Period-of-January-2019-June-2023.pdf>.

²³ Neni 2, Ligji për ndërmjetësim, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.114/2009.

²⁴ Neni 8, Ibid.

²⁵ Neni 6, Ibid.

²⁶ Neni 9, Ibid.

²⁷ Neni 13, Ibid.

sigurojnë informata për zgjidhjen e drejtë të marrëdhënies kontestuese ²⁸. Nga interpretimi i ligjit mund të konstatojm se mediacioni është procedur diskrete, neutral, vullnetar, i besueshëm, efikas, dhe mbi të gjitha i drejtë. Pra, për gjetjen e një zgjidhjeje që do të ishte e pranueshme për palët, atë zgjidhje e gjejnë vetë palët në kontest nëpërmjet mediatorit, ndërmjetësuesit.

Mediacioni është negociim i lehtësuar nga pala e tretë neutrale, është një proces fleksibil me përplotë variacione, por, që të gjitha mbështeten në vetëvendosjen e palëve për zgjidhjen e kontesteve. Mediatori udhëheq procedurën dhe thjeshtëson komunikimin mes palëve. Mediatori gjithmonë pritet të jetë i paanshëm, në zgjidhjen e kontestit. Në mënyrë praktike, mediacioni fillon me një seancë fillestare mes palëve dhe mediatorit, ku mediatori shpjegon procedurën dhe rregullat themelore, duke shkëmbyer kështu informacionet e para të nevojshme. Mediatori mbledh informacionet, dëgjon palët dhe parashtrohet pyetje. Në qoftë se palët arrijnë një marrëveshje, mediatori mund të ndihmojë në sqarimin dhe zbatimin e po kësaj marrëveshjeje.

Siç duket në Shtetet e Bashkuara dhe në pjesën tjetër të botës, mediacioni po zëvendëson arbitrazhin dhe procedurat tradicionale, si mënyra të zgjidhjes së kontesteve tregtare. Mediacioni mund të ndodhë në mënyra nga më të ndryshme. Më shpesh, palët dakordohen të ndërmjetësojnë përmes një klauzole "med-arb" me kusht që kontestet që rrjedhin nga kontrata do të ndërmjetësohen dhe, kur kjo dështon, zgjidhen përmes arbitrazhit detyrues²⁹.

Në momentin kur krahasojmë mediacionin dhe arbitrazhin, çuditërisht zbulojmë se një arbitër nuk është më i efektshëm në parandalimin e kontestit sesa një mediator, i cili vetëm mund të propozojë marrëveshje vetë-zbatuese. Rekomandimet e një mediatori shmangin kontestin vetëm kur të dy palët dakordohen. Strategjia e mediatorit në lidhje me kontestet private shpesh quhet "diplomaci"³⁰.

²⁸ Neni 14, Ligji për ndërmjetësim, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.114/2009.

²⁹ *Mediation of Investor-State Conflicts*, 2014

³⁰ J. HÖRNER, M. MASSIMO, & S. FRANCESCO, *Mediation and Peace*, 2015.

2. Arbitrazhi

Arbitrazhi³¹ nga gjuha frenge *arbitrage* që do të thotë gjykim, është një procedurë në të cilën një kontest u paraqitet, me marrëveshje të palëve, një ose më shumë arbitrave që marrin një vendim detyrues për kontestet. Arsyeja e zgjedhjes së arbitrazhit është se palët preferojnë të zgjedhin një procedurë private të zgjidhjes së kontesteve të tyre, sesa të shkojnë në gjykatë. Disa nga avantazhet e arbitrazhit janë:

<i>fleksibiliteti</i>	<i>kredibiliteti</i>	<i>profesionalizmi</i>	<i>efikasiteti</i>
-----------------------	----------------------	------------------------	--------------------

Kush janë arbitrat? Arbitrat marrin vendime njëloj sikurse gjykatësit. Arbitrat, ashtu si gjykatësit, janë qenie njerëzore, që të dy, arbitrat dhe gjyqtarët janë profesionistë, elitë të angazhuar në detyrën e zbatimit të parimeve ligjore dhe kanë një mandat ligjor për të ushtruar gjykimin e tyre në një mënyrë neutrale dhe objektive³². Përveç ngajshmërive, egzistojnë edhe dallime në mes tyre: gjyqtarët janë bartës të funksioneve publike, të cilët janë të caktuar nga vetë shteti, kanë funksion të përhershëm dhe gjykojnë në bazë të ligjit në fuqi, ndërkas arbitrat nuk janë bartës të funksioneve publike, kanë funksion të përkohshëm dhe gjykojnë në bazë të së drejtës materiale dhe procedurale, sipas së cilës e përcaktojnë vetë palët në kontrat³³.

Sidoqoftë, tashmë arbitrat janë aktorët kryesorë që dominojnë në zgjidhjen e kontesteve globale. Ata janë për zgjidhjen e kontesteve globale çfarë janë gjykatësit për zgjidhjen e kontesteve të brendshme. Arbitrat luajnë rol jetësor në ekonominë globale, mbikëqyrjen e kontratave që përfshijnë miliona e miliarda dhe marrin vendime që implikojnë sundimin e ligjit ndërkombëtar, gjithmonë duke ushtruar gjykimin e tyre në mënyrë neutrale dhe objektive.

Sipas maksimës “da mihi factum, dabo tibi ius”... Më jep faktet të të jap të drejtën, apo me rregullën "ligji ndjek faktet", me këto, mund të nënkuptojmë se ekziston një propozim ligjor për pothuajse çdo gjë, dhe arbitrat zbatojnë rregullin juridik që justifikon rezultatin që ata "ndjejnë" se është e drejta e bazuar në fakte. Nën procedurën e arbitrazhit, arbitri

³¹ Sipas Fjalorit të Shqipes së Sotme Arbitrazhi nënkupton zgjidhje e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve të ndryshme me anë të një komisioni arbitrash. Organ i posaçëm, që merret me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me karakter ekonomik, financiar ndërmjet palëve të ndryshme (Botimet Toena, 2002).

³² Inside the Arbitrator's Mind, 2017.

³³ M. J., *Hetemi, Arbitrazhi*, 2015.

mbledh informacione private nga palët dhe bën vendime të detyrueshme se si të zgjidhin kontestin. Zbatimi është i vështirë ose i pamundur kur palët janë subjekte të pavarura, por llogaritja e mekanizmave optimal të arbitrazhit ofron pika referimi të dobishme edhe për raste të tilla ³⁴. Parim bazë apo paradigma me të cilën udhëhiqet procedura e arbitrazhit është edhe maksima “*Ex aequo et bono*” sipas së cilës procedura e arbitrazhit, kontestin nuk e zgjidh sipas të drejtës pozitive të vendit, por sipas rregullave të mira dhe të drejta.

2.1.Arbitrazhi i përkohshëm

Arbitrazhi i përkohshëm apo *ad hoc* themelohet në bazë të kontratës së palëve dhe qëllimi është i ditur nga vetë emërtimi, që të gjykojë vetëm një kontest të caktuar, në mënyrë që më pas të pushojë se ekzistuari, pas gjykimit të atij kontesti. Arbitrazhi *ad hoc* është një proces shumë më i lehtë, i zgjedhur nga palët e përfshira përmes një kontrate. Një aspekt i rëndësishëm për këtë lloj arbitrazhi është se palët kanë fleksibilitet, të drejtë për të miratuar rregulla dhe zbatuar procedura, duke kursyer kështu kohë dhe para si dhe nuk mund të gjykojë rezultatet e arbitrazhit ad hoc ndonjë institucion tjetër i arbitrazhit. Pra në arbitrazhin ad hoc, palët organizojnë dhe planifikojnë arbitrazhin e tyre, duke përfshirë zgjedhjen e arbitrave, përcaktimin e rregullave, ligjin në fuqi dhe kompetencat e arbitrave.

2.2.Arbitrazhi institucional

Arbitrazhi institucional paraqet një aspekt tjetër procedural. Nga vetë përkufizimi i konceptit të "institucionit", procedura e tij duhet të jetë në përputhje me rregullat e një institucioni të arbitrazhit ³⁵. Arbitrazhi institucional apo i njohur ndryshe si arbitrazhi i përhershëm është organizatë permanente, e themeluar me detyrë, që t’u ushtrojë funksionin e gjykatës së zgjedhur, atëherë kur palët në kontest i drejtohen për këtë. Këto arbitrazhe janë shërbime joshtetërore, çdoherë në gatishmëri për t’u ndihmuar palëve që janë në kontest. Mundësia e palëve bashkë me arbitrat që t’i kërkojnë ndihmë institucionit, nga i cili janë themeluar, paraqet avantazh për arbitrazhin institucional. Në fakt, avantazhi kryesor i arbitrazhit institucional është ndërhyrja e drejtëpërdrejtë e po këtij institucioni në

³⁴ W. Kumberg, J. Lack, & M. Leathes, Enabling Early Settlement in Investor-State Arbitration: The Time to Introduce Mediation Has Come, 2014

³⁵ R. Muçaj, *International Arbitration as a Prerequisite in Today's Global Economy*, 2015.

udhëheqjen e procedurës së arbitrazhit, atëherë kur një gjë e tillë është e nevojshme. Është e vërtetë që arbitrazhi institucional thjeshtëson në thelb rolin e palëve dhe eliminon në një masë të madhe pengesat në zgjidhjen dhe përfundimin e kontestit, në mënyrë që, ai të mund të zbatohet, në mënyrë indirekte, për këtë alternativë në krahasim me arbitrazhin ad hoc, shanset për këtë të fundit variojnë në varësi të bashkëpunimit në mes palëve³⁶.

Kur palët zgjedhin arbitrazhin institucional, institucioni i arbitrazhit siguron rregulla për procedurën e arbitrazhit, kryen funksione mbikëqyrëse dhe administrative. Palët mund të zgjedhin institucion ndërkombëtar siç është *Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit* ose institucion kombëtar siç është *Shoqata Amerikane e Arbitrazhit*.

Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit u krijua nga Konventa e vitit 1899 për Zgjidhjen e Kontesteve Ndërkombëtare, ofron një laramani shërbimesh për zgjidhjen e kontesteve për komunitetin ndërkombëtar, duke ofruar shërbime për zgjidhjen e kontesteve që përfshijnë kombinime të ndryshme të shteteve, organizatave ndërqeveritare dhe palëve private. Ajo është e vendosur në Hagë, Hollandë. Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit, e themeluar në 1993 brenda, shoqatës jo-qeveritare Dhomës Ekonomike të Maqedonisë, ka autoritetin për të administruar kontestet e brendshme dhe ato ndërkombëtare³⁷.

3.Zgjidhja e kontesteve nga gjykatat në Maqedoninë e Veriut

“Në piramidën gjyqësore brenda sistemit juridik të një shteti, apo thënë ndryshe në organizimin e gjykatave të llojit të caktuar, ndikojnë faktorë si: numri dhe lloji kontesteve, rëndësia e kontesteve të caktuara, madhësia e territorit shtetëror, numri i banorëve, dhe, veçmas, principet e efikasitetit dhe ekonomisë”³⁸. Në sistemin gjyqësor³⁹ të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykata themelore, gjykata e apelit, gjykata administrative, dhe gjykata supreme⁴⁰. Sipas nenit 23 të Ligjit për gjykata, “Gjykatat themelore themelohen për një ose më shumë komuna, territori i së cilës përcaktohet me këtë ligj. Gjykatat themelore në pajtim me kompetencën lëndore gjykojnë në shkallë të parë

³⁶ G. Măgureanu, *Considerations on the Historical Development of Arbitration and New Tendencies in the Development of National and International Arbitration*, 2016.

³⁷ *Investment climate statements*, 2020.

³⁸ A. Јаневски, З. Т. Камилоска, *Граѓанско процесно право*. Скопје, 2009.

³⁹ *Gjykata e Strasburgut ka sjell 153 vendime gjyqësore kundër shtetit të Maqedonisë së Veriut, ku 108 prej tyre kishin të bëjnë me gjykime të stërzgjatura. Gabimet e tilla gjyqësore shtetit i kanë kushtuar 2 milionë euro. 19 Janar 2020:*

<https://www.google.com/amp/s/www.evropaelire.org/amp/gabime-gjyqesore-maqedoni-e-veriut-/30385733.html>

⁴⁰ Neni 22, Ligji për gjykatat, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.58/2006.

dhe themelohen si gjykata me kompetencë themelore dhe gjykata me kompetencë të zgjeruara. Në kuadër të gjykatave themelore me kompetencë të zgjeruar themelohen sesione gjyqësore të specializuara që do të veprojnë në lidhje me konteste të llojeve të caktuara⁴¹”.

3.1. Inicimi i procedurës

Inicimi i procedurës bëhet me padi nga vetë palët e përfshira në kontest. Palë mund të jenë: secili person fizik dhe juridik. Ndërkaq, me dispozita të veçanta sipas Ligjit për procedurë kontestimore, përcaktohet se kush mund të jetë tjetër palë në procedurë përveç personave fizikë dhe juridikë. Gjukata me përjashtim në procedurë të caktuar, mund t'ua pranojë cilësinë e palës edhe personave të cilët nuk e kanë aftësinë e palës, nëse vërteton se duke marrë parasysh lëndën e kontestit, i plotësojnë kushtet për marrjen e cilësisë së palës⁴². Gjatë tërë procedurës gjykata me detyrë zyrtare do të ketë kujdes nëse personi i cili paraqitet si palë është i aftë për kontest, nëse palën e paaftë për kontest e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizim të veçantë⁴³. Shtetasi i huaj i cili është i paaftë për kontest sipas ligjit të shtetit shtetas i të cilit është, ndërsa është i aftë për kontest sipas ligjit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mundet vetë të ndërmarrë veprime në procedurë. Përfaqësuesi ligjor mund të ndërmarrë veprime në procedurë vetëm derisa shtetasi i huaj nuk deklaron se vetë e ndërmerr udhëheqjen e kontestit⁴⁴. Mund të kemi një ose më shumë paditës, të njohur nga ligji si bashkëkontestimorë. Bashkëkontestimorët mund të paraqiten nëse: në pikëpamje të lëndës në kontest janë në bashkësi juridike, nëse të drejtat e tyre respektivisht obligimet dalin nga baza e njëjtë faktike dhe juridike, lëndë e kontestit janë kërkesa respektivisht obligime nga lloji i njëjtë që bazohen mbi bazë themelore faktike dhe juridike të llojit të njëjtë edhe pse ekziston kompetencë reale dhe vendore në të njëjtin gjykatë për secilën kërkesë dhe për secilin të paditur dhe ajo është e përcaktuar me ligj tjetër⁴⁵.

Procedura e kontestit fillon me dorëzimin e padisë nga ana e të paditurit. Në pikëpamje

⁴¹ Neni 23, Ligji për gjykatat, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.58/2006.

⁴² Neni 70, Ligji për procedurë kontestimore, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.79/2005, kundër aktvendimit në procedurë lejohet ankesë e veçantë, Ligji për procedurë kontestimore, neni 70 alineja 4.

⁴³ Neni 74, Ibid.

⁴⁴ Neni 79, Ibid.

⁴⁵ Neni 186, Ibid.

të kërkesës që e ka paraqitur pala në vijimin e procedurës, kontesti fillon të vijoj nga momenti kur është informuar pala e kundërt për atë kërkesë. Deri sa vijon kontesti, në pikëpamje të kërkesës së njëjtë nuk mund të inicohet kontest i ri midis palëve të njëjtë, në qoftë se kontesti i tillë inicohet, gjykata ka të drejtën të hedhë poshtë padinë. Gjykata gjatë tërë procedurës me detyrim zyrtar kujdeset se a vijon kontest tjetër, me kërkesë të njëjtë, nga paditës të njëjtë ⁴⁶.

Sa u përket shpenzimeve gjatë procedurave të kontesteve, ligji parasheh që: “Pala e cila humbë kontestin, është e detyruar që palës tjetër dhe ndërhyrësit t’ua kompensojë shpenzimet. Nëse pala pjesërisht ka sukses në kontest, gjykata, mund të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta ose njëra palë t’ia kompensojë palës tjetër dhe ndërhyrësit pjesën e barabarta të shpenzimeve⁴⁷. Ndërsa në bazë të *nenit 155 të Ligjit për procedurë kontestimore*, palët në kontest i bartin shpenzimet në pjesë të barabarta.

3.2. Gjykatat kompetente

Kompetente për zgjidhjen e kontesteve investuese është gjykata themelore. Gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar, janë kompetent të vendosin për punë civile dhe tregtare, edhe atë: për konteste të personave juridikë të vendit dhe të huaj që dalin nga marrëdhëniet e tyre të ndërsjella ekonomike, respektivisht tregtare⁴⁸. Në bazë të Ligjit për procedurë kontestimore, “Gjykata me detyrë zyrtare, gjatë tërë procedurës, ka kujdes nëse zgjidhja e kontestit është në kompetencën e gjykatës dhe nëse zgjidhja e kontestit është në kompetencë të gjykatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nëse gjykata gjatë procedurës konfirmon se për zgjidhjen e kontestit nuk është gjykata kompetent por ndonjë organ tjetër vendor, do të shpallet si jo kompetent, do të ndërpresë veprimet e realizuara në procedurë dhe do t’a hedh poshtë padinë, përveç në rastet në të cilat kompetenca e gjykatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut varet nga pëlqimi i të paditurit, e ai e ka dhënë pëlqimin e vet” ⁴⁹. Sa u përket kontesteve me element ndërkombëtar, “Gjykata në Republikën e Maqedonisë së Veriut është kompetent për gjykim nëse kompetenca e tij në kontestin me elementin ndërkombëtar është përcaktuar në mënyrë të prerë me ligj ose me

⁴⁶ Neni 184, Ligji për procedurë kontestimore, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.79/2005

⁴⁷ Neni 148, Ibid.

⁴⁸ Neni 31, alineja 2, Ligji për gjykatat, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.58/2006.

⁴⁹ Neni 15, Ligji për procedurë kontestimore, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.79/2005

marrëveshje ndërkombëtare. Nëse në ligj ose në marrëveshjen ndërkombëtare nuk ka dispozitë të prerë për kompetencën e gjykatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut për konteste të llojit të caktuar, atëherë gjykata në Republikën e Maqedonisë së Veriut është kompetent për gjykimin e llojit të atillë të kontesteve edhe nëse kompetenca e tij del nga dispozitat e ligjit për kompetencën vendore të gjykatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut”⁵⁰. Në *nenin 461 alineja 1 dhe 2 të Ligjit për procedurë kontestimore*, ligjvënësi parasheh që: “Në kontestet afariste për kërkesë në para vlere e së cilës nuk i tejkalon 1 000 000 denarë, e për të cilat procedura inicohet me padi para gjykatës, palët janë të obliguara që para paraqitjes së padisë të tentojnë kontestin ta zgjidhin nëpërmjet mediacionit”⁵¹. Në kontestet për arsye të vërtetimit të ekzistimit apo të mosekzistimit të marrëveshjes, për arsye të ekzekutimit apo prishjes së marrëveshjes, si dhe në kontestet për arsye të kompensimit të dëmit për arsye të mosekzekutimit të marrëveshjes, krahas gjykatës me kompetencë të përgjithshme të vendit, kompetente vendore është edhe gjykata e vendit ku sipas marrëveshjes së palëve i padituri është i obliguar ta ekzekutojë marrëveshjen⁵². Në procedurën e kontesteve ekonomike, gjyqtari individual gjykon nëse vlere e lëndës së kontestit nuk e tejkalon shumën prej 3 000 000 denarë, ndërsa në kontestet për pagesë të kamatës pa marrë parasysh vlerën e lëndës së kontestit⁵³. Nga një këndvështrim tjetër, “Gjykatat e shtetit amë të investitorit edhe në shtetet e treta thjeshtë nuk janë alternativë racionale në shumicën e rasteve të juridiksioneve territoriale mbi investimet që realizohen në shtetet tjera. Pak është e mundur që një shtet i tretë që të pajtohet të merr pjesë në zgjedhjen e gjykatës kompetente në kontestin e investimeve po që se ajo nuk është shtet-vendas në investim”⁵⁴. E thënë thjeshtë, për këto shkaqe mënyrat alternative të zgjidhjes së kontesteve për të cilat folëm më lartë dhe për të cilat do të flasim më poshtë japin një qasje më të drejtë për investitorët e huaj.

⁵⁰ Neni 26, Ligji për procedurë kontestimore, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.79/2005

⁵¹ Gjatë paraqitjes së padisë, paditësi është i obliguar të bashkëngjisë dëshmi me shkrim të lëshuar nga mediatori se tentimi për zgjidhjen e kontestit me mediacion nuk ka pasur sukses.

⁵² Neni 466, Ibid

⁵³ Neni 467, Ibid

⁵⁴ R. Dolzer, Ch. Schreuer, *Principles of International Investment Law*, 2008.

KREU III

ZGJIDHJA E KONTESTEVE INVESTUESE NË TË DREJTËN KOMPARATIVE

Kur flasim për *kontestet*, mund të kemi një gamë të gjerë interpretimi. Ndërsa, kur flasim veçanërisht për *kontestet investuese* dhe që të mund të japim një përkufizim më të saktë të së njëjtës, në një farë mënyre nënkuptojmë: Mosmarrëveshje midis dy investitorëve që tregojnë pikëpamje të kundërta, apo mosmarrëveshje shtet/investitorë. Kështu që zgjidhja e kontesteve është procedura e arritjes së një epilogu midis këtyre kontesteve, të investitorëve apo shteteve. Studiues të ndryshëm termin “zgjidhja e kontesteve” e përdorin në vend të njëjtë me “zgjidhja e konflikteve”, por ashtu siç dihet konfliktet në thelb janë më të rrënjosura dhe shumë më të gjata se kontestet.

Në vitet e fundit, instrumentet dhe institucionet për zgjidhjen e kontesteve janë shtuar e shumëfishuar. Ato, tani mbulojnë pothuajse të gjitha fushat e së drejtës ndërkombëtare duke filluar nga e drejta tregtare ndërkombëtare, e drejta penale ndërkombëtare deri nga më tradicionajla, siç është procedura e arbitrazhit. Mirëpo në të shumtën e rasteve një investitor do të tentoj të zgjidhë kontestet në mënyrë joformale para se të kërkojë një kërkesë për arbitrazh. Për shembull: Investitori mund të kontaktojë zyrtarë të qeverisë në shtetin që ka investuar për të diskutuar një kontest që ka lindur. Pra “shteti” drejtëpërdrejt mund të marrë një informim nga investitori i huaj, për masat e miratuara nga po ai shtet ose mosveprimet nga ana e tij që ndikojnë negativisht në të drejtat e investitorit sipas marrëveshjes ndërkombëtar të investimeve, ose ligjeve të investimeve të përcaktuara në atë investim. Në fakt, kjo është një mundësi e mirë për shtetin që të ketë një vlerësim paraprak të situatës dhe njëkohësisht për të përcaktuar nëse mund ta zgjidhë kontestin para se i njëjti të thellohet në procedura të mëtejme. Këto procedurat të brendshme duhet të jenë të vendosura aq mirë sa që investitori të jetë i bindur që informacioni i tillë ju drejtohet zyrtarëve të duhur të cilët mund të adresojnë kontestin në fjalë. Supozojmë se shteti ka një agjension të caktuar për arbitrazhin e investimeve, kjo pikërisht do të ishte vendi i duhur ku investitorët apo vetë shteti mund të konsultohet në këtë fazë. Edhe pse disa mekanizma

investimi kërkojnë që një investitor i huaj të informoj qeverinë në mënyrë formale me njoftime zyrtare për një kërkesë të tillë. Rregullat e Arbitrazhit ICSID nuk përcaktojnë një kërkesë të tillë, por sipas rregullave të arbitrazhit, shteteve ju këshillohet vetëm për *kërkesën për arbitrazh*⁵⁵.

Në vazhdim të hulumtimit do të paraqesim komparacion mes shteteve të Evropës, shteteve të Azisë, Amerikës Veriore, Rusisë. Pra një miks shtetesh të vogla, të mesme dhe të mëdha. Natyrisht, një reagim i tillë do të ishte: Se si është e mundur që Maqedonia e Veriut të krahasohet me superfuqinë ekonomike më të madhe në botë siç është Amerika apo me një nga shtetet superiore për investime siç është Kina, duke mos lënë anash dhe me shtetet Evropiane të zgjedhura, ku siguria me e madhe financiare është në Zvicër. Po, ne jemi një shtet i vogël, mirëpo faktori determinant për Maqedoninë e Veriut është pozita gjeostrategjike shumë e rëndësishme e saj, ku një nga avantazhet e saja është *rruga ndërkombëtare E-75*, e cila i lidh vendet Evropiane me vendet e Lindjes së Afërme përmes Greqisë. Bën bashkimin e dy kontinenteve, si dhe shumë shteteve. Pikërisht, kjo rrugë shfaq edhe interesim për ndërkombëtarët për sa u përket investimeve në Maqedoninë e Veriut.

Ashtu siç edhe thamë më lartë, do të paraqesim komparacione legjislativësh shtetërore për: Gjermaninë; Austrinë; Italinë; Suedinë; Zvicrën; Turqinë; Emiratet e Bashkuara Arabe; Shtetet e bashkuara të Amerikës; Kinën dhe Rusinë.

I.ZGJIDHJA E KONTESTEVE INVESTUESE SIPAS LEGJISLACIONEVE NË DISA SHTETE

1.Gjermania

Sistemi gjyqësor gjerman gëzon një reputacion të lartë në botë. Në bazë të projektit të drejtësisë botërore "Indeksi i Sundimit të Ligjit 2020" Gjermania rënditet në vendin e gjashtë, dhe në veçanti në lidhje me të drejtën civile, Gjermania rënditet e katërta në të gjithë botën.

1.1.Zgjidhja e kontesteve investuese nga gjykatat

Organizimi i gjykatave në çështjet e së drejtës civile në shtetin gjerman ndahen në dy

⁵⁵ Icsid practice notes, 2015.

nivele, gjykata lokale dhe gjykata rajonale të cilat veprojnë si gjykata të shkallës së parë. Sa i përket inicimit të kërkesave, varen varësisht nga vlerat që kanë të bëjnë në konteste: kërkesat që tejkalojn vlerën prej 5000 euro duhet të inicohen në gjykatat rajonale, ndërsa kërkesat me një vlerë më të ulët duhet të inicohen në gjykatat lokale. Edhe pse mund të zbatohen përjashtime për kontestet më specifike. Kohëzgjatja e procedurave të shkallës së parë ndryshon, varësisht nga kompleksiteti i kontestit (mesatarisht ndërmjet 8/11 muaj; 6/8 muaj; 14/19 muaj dhe në raste më specifike mund të ndodhë që të kaloj më shumë se dy vite deri në një vendim përfundimtar). Në rastet e procedurave gjyqësore komplekse ndërkombëtare, procedurat e shkallës së parë dhe të dytë mund të zgjasin pak më shumë. Seancat dëgjimore janë një pjesë e rëndësishme e procedurës gjyqësore, si dhe pjesëmarrja fizike e palëve duhet të jetë e rregullt dhe e detyrueshme. Gjuha që flitet në seancë është gjermanishtja. Në rast se njëra palë nuk flet ose kupton gjermanisht, mund të kërkohej përkthyes, ose përjashtimisht kur që të dy palët nuk flasin ose kuptojn gjermanisht atëherë mund të zhvillohet procedura në gjuhën angleze, por gjithësesi të gjitha dokumentet duhet që të përkthehen në gjermanisht. Kodi procedural civil lejon gjithashtu që palët, dëshmitarët dhe ekspertët të mund të kërkojnë pjesëmarrje përmes transmetimit të videokonferencës; megjithatë, gjykatat kanë hezituuar në këto raste. Tani, mbetet për t'u parë në qoftë se pandemia COVID19 dhe kufizimet e saj do të ndryshojnë këto hezitime. Kostot e procedurës gjyqësor në Gjermani janë mjaft të parashikueshme, të cilat rregullohen me ligj. Shuma e tarifave varet në përgjithësi nga përlllogaritja e shumës në konteste. Sa më të larta shumat në konteste, aq më të larta janë tarifat. Sidoqoftë, ligji përcakton një kufizim për llogaritjen e tarifave deri në 30 milion euro për paditës.

1.2.Zgjidhja e kontesteve përmes Arbitrazhit

Kodi Gjerman i procedurës civile përmban rregulla mbi arbitrazhin që bazohen në Ligjin Model të *UNCITRAL* mbi arbitrazhin ndërkombëtar konkretisht në nenet 1025–1066. Sidoqoftë, shumica e këtyre rregullave zbatohen vetëm nëse palët nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje paraprake. Gjermania është një shtet nënshkrues i *Konventës së Kombeve të Bashkuara për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj*. Kështu, një gjykim i dhënë nga një gjykatë arbitrazhi - *Schiedsgerichtsbarkeit*, në përputhje me Konventën e New Yorkut njihet dhe, në përgjithësi, është i zbatueshëm. Çdo çështje e lidhur me arbitrazhin vendoset nga gjykatat e larta rajonale. Në qoftë se konstatohen shkelje të ligjeve në

vendimet e gjykatave, palët mund të adresohen në Gjykatën Federale Gjermane të Drejtësisë.

1.3.Zgjidhja e kontesteve përmes mediacionit

Mediacioni është një mekanizëm alternativ për zgjidhjen e kontesteve në Gjermani. Palët mund të përfshijnë një mediator para ose pas inicimit të kontestit në procedurë gjyqësore. Për shkak se një zgjidhje kontesti mund të arrihet nëpërmjet mediacionit, gjyqëtari do të duhet të prolongoj seancën për aq kohë sa zgjat mediacioni. Në qoftë se procedura e mediacionit është e pasuksesshme, procedura gjyqësore do të vazhdojë. Në mungesë të një klauzole për zgjidhjen e kontesteve, mediacioni, në përgjithësi, nuk është një parakusht për të zgjidhur një kontest përpara një gjykate. Zgjidhjet e kontesteve të arritura gjatë mediacionit konsiderohen se janë kontrata ligjore. Nëse përveç procedurave të mediacionit përfshihet procedura gjyqësore, zgjidhja do të zyrtarizohet nga gjykata. Përndryshe, zgjidhja mund të zyrtarizohet edhe nga noteri. Në të dy rastet, dokumenti që përmban zgjidhjen e kontestit midis palëve, shërben si vendim i zbatueshëm⁵⁶.

2.Austria

Në sistemin juridik austriak, bëhet ndarje në mes procedurave të së drejtës publike dhe procedurave të së drejtës civile. Procedurat civile përfshijnë kontestet private në procedura gjyqësore në mes personave fizikë ose personave juridikë që kundërshtojnë njëri-tjetrin në të njëjtin nivel. Në procedurat e së drejtës publike, nga ana tjetër, një autoritet publik me pushtet sovran vepron kundër një subjekti juridik.

2.1.Zgjidhja e kontesteve investuese nga gjykatat

Për zgjidhjen e një kontesti civil, palët gjithmonë janë të lira të arrijnë një marrëveshje paqësore, jashtë procedurës gjyqësore siç përcaktohet në nenin 1380 të Kodit Civil Austriak- *Allgemeines Bürgerliches Gesetzbuch*. Në qoftë se një procedurë gjyqësore civile tashmë është inicuar, ajo fillon të vijoj nga zhvillimi i një seance verbale si dhe nga nënshkrimet e palëve në kontest. Kjo zgjidhje përfundon me një vendim gjyqësor- *Exekutionsordnung*.

⁵⁶ Litigation & Dispute resolution, Germany, Retrieved 10 September 2020 from:<https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/litigation-and-dispute-resolution-laws-and-regulations/germany>.

Rëndësia e mediacionit në kontekstin e zgjidhjes së kontestit, pa një vendim gjyqësor ose të një gjykate arbitrazhi, nuk duhet të nënvlerësohet. Përfshirë mediacionin e përgjithshëm, të rregulluar në Aktin Federal për Mediacion në Çështjet e Ligjit Civil- *Bundesgesetz über Mediation in Zivilrechtssachen*, procedurat e mediacionit në lidhje me çështjet ndërkufitare brenda BE-së janë të rregulluara me Aktin Evropian për Mediacion- *EU Mediation Gesetz*.

Vendimet e arbitrazhit, si dhe vendimet e gjykatave zbatohen përmes Rregullave Procedurale të Zbatueshme të Aktit Austriak- *Exekutionsordnung*, i cili kërkon një urdhër gjykate për garantim të vendimit. Urdhra të tillë gjyqësorë që garantojnë vendimet zakonisht jepen pa një seancë verbale nëse vendimi ose aktgjykimi është i zbatueshëm. Lidhur me njohjen dhe zbatimin e gjykimeve të huaja, ekzistojnë marrëveshje bilaterale dhe multilaterale. Një nga më të rëndësishmet konsiderohet *Konventa e Luganos*. Ndërsa vendimet nga gjykatat e shteteve anëtare të BE-së mund të njihen në përputhje me *Rregulloren e Brukselit*. Në procedurën për të marrë njohjen e një vendimi gjyqësor nga një shtet tjetër anëtar i BE-së, pala duhet të sigurojë një kopje të aktgjykimit që plotëson kushtet e nevojshme për të vërtetuar vërtetësinë e tij dhe një certifikatë në përputhje me nenin 53 të Rregullores së Brukselit. Konventa e Luganos ofron një sistem shumë të ngjashëm me Rregulloren e Brukselit për njohjen dhe zbatimin e vendimeve. Prej kohësh Austria është një shtet anëtar i Konventës së Nju Jorkut të vitit 1958 mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja të arbitrazhit ndjekin procedurat e përcaktuara në këtë konvent dhe janë të zakonshme në Austri. Për kontestet brenda-evropiane, çështja nëse një padi civile mund të inicohet në shtetin e Austrisë përcaktohet sipas Rregullores për Njohjen dhe Zbatimin e Aktgjykimeve në Çështje Civile dhe Tregtare. Për kontestet jashtë-evropiane, legjislacioni ndërkombëtar rregullohet nga Rregullorja mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet Kontraktuese. Të dy rregulloret janë detyruese, prandaj përcaktojnë kushtet përmes së cilëve mund të inicohet një procedurë gjyqësore në Austri me palë në kontest të kombësive të ndryshme. Rregulloret e sipërpërmendura përcaktojnë shprehimisht kushtet nën të cilat palët mund të arrijnë një marrëveshje ndërkombëtare. Në qoftë se procedura nuk është sjellë në Austri, është akoma e mundur, me anë të një letërporosie, të rregullohet që dëshmitarët e vendosur në Austri të dëgjohen para gjykatave kombëtare përmes video konferencës. Nga ana tjetër, konfiskimi i pasurive nuk është i mundur sipas ligjit civil, por vetëm në bazë të urdhrave të gjykatës penale në lidhje me një vepër penale. Paditë nga gjykatat e shteteve të tjera që do të

parandalonin procedurën në këtë vend nuk janë të zakonshme në Austri.

2.2.Zgjedhja e kontesteve përmes arbitrazhit

Kodi i Procedurës Civile Austriake – *Zivilprozessordnung*, siguron një ligj modern të arbitrazhit për procedurat e arbitrazhit kombëtar dhe ndërkombëtar, duke pasqyruar në mënyrë thelbësore Ligjin Model të *UNCITRAL* mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, duke i dhënë një shkallë të madhe të autonomisë dhe pavarësisë së palës në procedurë arbitrazhi. Për veprimet që rrjedhin nga procedurat e gjykatës së arbitrazhit, Gjykata Supreme-*Oberster Gerichtshof*, ka juridiksion të veçantë. Në qoftë se gjykata e arbitrazhit nuk është kompetente për të kryer veprime të caktuara gjyqësore, ajo mund të kërkojë nga gjykata që të kryejë veprimin në fjalë. Masat e përkohshme mund të kërkojnë nga një palë në gjykatën e arbitrazhit dhe do të zbatohen nga gjykata kompetente e rrethit. Institucioni më i rëndësishëm i arbitrazhit i Austrisë për arbitrazhin komercial ndërkombëtar është VIAC, Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit të Vienës e Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë, që vepron sipas Rregullave të Vienës, e cila përfshin rregullat e mediacionit, si dhe rregullat e arbitrazhit.

2.3.Zgjidhja e kontesteve përmes mediacionit

Mediacioni në shtetin austriak është duke fituar një popullaritet gjithnjë e më shumë gjatë viteve të fundit. Mediacioni në Austri rregullohet nga Akti Federal për Mediacion në Çështjet e së Drejtës Civile- *Mediation Bundesgesetz über von Zivilrechtssachen*. Përmes nenit 433a të Kodit të Procedurës Civile- *Zivilprozessordnung*, në një zgjidhje të arritur në një procedurë mediacioni, një titull i zbatueshëm mund të merret në çdo gjykatë rrethi (zgjidhje për mediacion, *Mediationsvergleich*). Për më tepër, nuk është e pazakontë që gjyqtarët të inkurajojnë informalisht palët që t'i drejtohen mediacionit për të zgjidhur kontestet. Në lidhje me mediacionin ndërkufitar brenda BE-së, Akti Evropian i Ndërhyrjes - *EU Mediation Gesetz*, u prezantua si zbatim mbi aspekte të caktuara të mediacionit në çështjet civile dhe tregtare⁵⁷.

⁵⁷ Litigation & Dispute resolution, Austria, Retrieved 28 August 2020 from: <https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/litigation-and-dispute-resolution-laws-and-regulations/austria>.

3.Italia

Sistemi gjyqësor civil italian rregullohet me Kushtetutën Italiane, Kodin e Procedurës Civile dhe nga ligje të veçanta. Gjatë inicimit të procedurës pala mund të paraqesë kërkesë hardcopy ose në mënyrë elektronike. Me përjashtim të deklaratës së mbrojtjes, parashtresat janë të vlefshme vetëm kur paraqiten përmes sistemit elektronik të menaxhuar nga Ministria e Drejtësisë, pasi që procedura gjyqësor civile menaxhohet në mënyrë elektronike.

3.1.Zgjidhja e kontesteve përmes arbitrazhit

Ligji italian nuk bën dallim mes arbitrazhit vendas apo ndërkombëtar. I vetmi kriter ende i vendosur është ai i selisë së arbitrazhit. Në qoftë se arbitrazhi është i vendosur në Itali, zbatohet ligji italian, edhe në rast se ka elementë ndërkombëtarë, arbitrazhi do të konsiderohet arbitrazh vendas italian, në qoftë se selia është në Itali.Arbitrazhi rregullohet në nenet 806–840 të Kodit të Procedurës Civile.

3.2. Zgjidhja e kontesteve përmes mediacionit

Paditësi së pari do të tentoj të kërkojë një zgjidhje miqësore përmes një procedure mediacioni. Mediacioni është i detyrueshëm për çështjet që kanë të bëjnë me bashkëpronësinë; kompensimin e dëmeve mjekësore, shpifjet; marrëveshjet bankare dhe financiare, etj. Mediacioni mund të zgjasë deri në tre muaj, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për mediacion. Nëse arrihet një marrëveshje, e nënshkruar siç duhet nga palët dhe mbrojtësit e tyre, ajo ka të njëjtënvlerë si një dokument përmbarues⁵⁸.

4.Suedia

Me një legjislacion arbitrazhi miqësor, neutral dhe të besueshëm, Suedia njihet si një nga vendet më të preferuara për zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare përmes procedurës së arbitrazhit. Kjo ka tërhequr palë nga e gjithë bota për të zgjidhur kontestet e tyre përmes arbitrazhit në Suedi ose duke zgjedhur arbitra suedezë. Arbitrazhi ka qenë për një kohë të gjatë gjithashtu metoda e preferuar për zgjidhjen e kontesteve për kontestet tregtare në Suedi. Një numër i madh i kontratave tregtare suedeze përfshijnë një klauzolë arbitrazhi. Si

⁵⁸ Litigation & Dispute resolution, Italy, Retrieved 29 September 2020 në: <https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/litigation-and-dispute-resolution-laws-and-regulations/italy>.

rezultat i kësaj, shumë avokatë suedezë kanë njohuri të shëndosha të ligjit të arbitrazhit dhe gjykatat suedeze janë me përvojë në trajtimin e procedurave të kundërshtimit dhe çështjeve të tjera të lidhura me arbitrazhin. Instituti i Arbitrazhit i Dhomës së Tregtisë së Stokholmit ka patur një rol të rëndësishëm në këtë zhvillim dhe është një nga arsyet kryesore pse shumë kontrata ndërkombëtare përfshijnë një klauzolë arbitrazhi që përcakton Suedinë si selinë e arbitrazhit. Instituti i Arbitrazhit i Dhomës së Tregtisë së Stokholmit është një institut arbitrazhi i njohur ndërkombëtarisht me nga 200 çështje të reja të paraqitura në vit, gjë që e bën atë një nga institucionet kryesore të arbitrazhit në botë. Përafërsisht gjysma e çështjeve të trajtuara janë ndërkombëtare. Gjithashtu luan një rol udhëheqës si administrator i kontesteve të shteteve investitorë dhe ka një ngarkesë të dytë pas ICSID⁵⁹.

5.Zvicra

E vendosur në zemër të Evropës, Zvicra është një vend i së drejtës civile me një traditë të gjatë si një nga vendet kryesore globale për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar dhe çështjet gjyqësore tregtare. Zvicra ka një sistem të besueshëm gjyqësor dhe gjyqtarët e saj janë të njohur për paanësinë dhe pavarësinë e tyre. Zvicra ka të nënshkruara një numër të madh të marrëveshjeve ndërkombëtare që janë të rëndësishme në kontekstet ndërkombëtar.

5.1.Zgjidhja e kontesteve nga gjykatat

Në vitin 2019, kohëzgjatja mesatare e procedurave në çështjet civile para Gjykatës Supreme të Zvicrës zgjatën deri në 128 ditë deri në gjykim dhe 145 ditë deri në nxjerrjen e vendimit me shkrim.Procedura zhvillohet në një nga gjuhët zyrtare të Zvicrës: gjermanisht, frëngjisht ose italisht, në varësi të gjuhës zyrtare të kantonit. Sidoqoftë, ndonjëherë gjyqtarët janë të gatshëm të zhvillojnë seancën në gjuhën angleze, në rast se përfshihet një palë e huaj dhe me kusht që asnjë palë tjetër të mos kundërshtojë. Procedurat gjyqësore në çështjet civile rregullohen kryesisht nga Kodi i Procedurës Civile Zvicerane i 1 Janarit 2011, i rishikuar më 26 Shkurt 2020. Në kontestet me elementë ndërkombëtarë, procedurat

⁵⁹ *Litigation & Dispute resolution, Sweden, Retrieved 19 September 2020 from: <https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/international-arbitration-laws-and-regulations/sweden>.*

gjyqësore rregullohen nga rregullat e së drejtës ndërkombëtare private të Zvicrës të përcaktuara në Aktin Zviceran për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale. Procedurat civile në Zvicër janë të shpejta dhe jo shumë të komplikuar, ato fillojnë duke paraqitur një deklaratë kërkesë. Pas marrjes së deklaratës së kërkesës, gjykata urdhëron paditësin të paguajë një paradhënie për shpenzimet. Zakonisht procedurat strukturohen në tre faza: *Në fazën e parë*, bëhen pohimet faktike, *në fazën e dytë*, provat merren nga gjykata, *faza e fundit* e procedurës është faza pas dëgjimit, ku palët mund të komentojnë në lidhje me rezultatin e marrjes së provave dhe, pas kësaj, merret vendimi. Vendimet e Gjykatave të apelit kantonal ose Gjykatat tregtare mund të inicohen në Gjykatën e Lartë Federale Zvicerane në Lozanë, me kusht që shuma në konteste të jetë së paku 30,000 franga zvicerane.

5.2.Zgjidhja e kontesteve përmes arbitrazhit

Për më shumë se një shekull, Zvicra ka qenë një nga vendet e preferuara për mbajtjen e arbitrazheve ndërkombëtare. Qasja miqësore ndaj arbitrazhit, sistemi juridik i zhvilluar mirë, vend i përshtatshëm gjeografikisht, infrastrukturë e shkëlqyeshme si dhe mendje e hapur ndaj vlerave, kulturave dhe perceptimeve të ndryshme vazhdojnë ta bëjnë atë një vend kryesor për arbitrimin e kontesteve ndërkombëtare⁶⁰. Ndër vendet kryesore në botë për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar konsiderohen qytetet zvicerane Gjeneva dhe Cyrihu. Nga një sondazh i kryer në emër të Parlamentit Evropian, 85.62% rekomanduan Zvicrën, më shumë se çdo shtet tjetër i përfshirë në studim. Një nga faktorët që ka kontribuar që Zvicra të bëhet një nga legjislacionet kryesore ndërkombëtare të arbitrazhit në botë është edhe legjislacioni i saj, standardet e larta profesionale në profesionet e avokatit, si dhe reputacioni i Zvicrës për neutralitet dhe stabilitet politik. Palët janë të lirë të bien dakord për të gjitha aspektet e procedurës së arbitrazhit dhe të përshtatin arbitrazhin me nevojat specifike të çështjes së tyre. Sa u përket shpenzimeve procedurale, për shembull në kantonin e Cyrihut, zbatohen normat e mëposhtme në procedurat civile: nëse vlera e kontestit arrin në 100000 franga, shpenzimet e palës janë rreth 11000 franga dhe gjykata kushton 9000 franga; nëse vlera është prej 1 milion franga, si shpenzimet gjyqësore ashtu edhe kostot e palës arrijnë në rreth 31000 franga për secilën palë; nëse vlera në kontest është 10 milion franga, shpenzimet e palëve arrijnë afërsisht 106000 franga dhe shpenzimet gjyqësore 120000 franga.

⁶⁰ *International arbitration, Switzerland 2020*

Arbitrazhet ndërkombëtare në Zvicër rregullohen nga Kapitulli 12 i Aktit Zviceran për të Drejtën Ndërkombëtare Private, Ligjin Zviceran të Arbitrazhit. Ligji Zviceran i Arbitrazhit, i jep rëndësi të madhe autonomisë së vullnetit të palëve për shumicën e çështjeve dhe, në mungesë të një marrëveshje midis palëve, lejon diskrecion të gjerë në gjykatat e arbitrazhit. Zvicra është nënshkruese në Konventën e New Yorkut për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj 1958. Gjithashtu, Qendra e Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale WIPO, me qendër në Gjenevë, ofron mundësi alternative për zgjidhjen e kontesteve tregtare ndërkombëtare midis palëve private⁶¹.

6.Turqia

Sistemi gjyqësor i Turqisë i është nënshtruar reformave të vazhdueshme për të rritur efikasitetin e saj. Reformat kanë sjellë, ndër të tjera, risi të rëndësishme teknologjike dhe strukturore.Turqia është zbatuese e Sistemit Kombëtar të Informatikës së Gjyqësorit – UYAP, kështu duke ju mundësuar gjykatave dhe individëve të kryejnë akte procedurale përmes internetit. Kjo platform, e cila është përmirësuar vazhdimisht në vitet e fundit, lehtëson jetën e çdo praktikanti ligjor në Turqi, që do të thotë se edhe avokatëve nuk u kërkohet më të vizitojnë fizikisht gjykatën. Për më tepër, seanca dëgjimore në internet në gjykatat civile përmes UYAP, ka qenë në agjendën e Ministrisë së Drejtësisë për një kohë. Kjo mundësi është në dispozicion në gjykatat penale që nga viti 2012 dhe u bë urgjente edhe për çështjet civile, për shkak të efekteve të COVID-19.

6.1.Zgjidhja e kontesteve përmes arbitrazhit

Në përputhje me trendin e përgjithshëm ndërkombëtar, arbitrazhi po bëhet metoda kryesore e zgjidhjes së kontesteve për kontestet ndërkufitare në Turqi. Ligji Ndërkombëtar i Arbitrazhit – IAL, përshkruan parimet dhe procedurat në lidhje me procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar, ku në qoftë se ekziston një element i huaj, Turqia përcaktohet si selia e arbitrazhit. Prandaj, palët ose mund të bien dakord mbi rregullat e arbitrazhit që do të zbatohen, ose t'i përcaktojnë ato duke iu referuar rregullave ndërkombëtare ose institucionale të arbitrazhit. Dy institucionet e shquara të arbitrazhit në

⁶¹ *Litigation & Dispute resolution, Swiss*, Retrieved 29 August 2020 from: <https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/litigation-and-dispute-resolution-laws-and-regulations/switzerland>.

Turqi konsiderohen: ISTAC e themeluar në 2014, që synon të bëhet një institucion rajonal i arbitrazhit ndërkombëtar dhe të rrisë kërkesën për arbitrazh në Turqi, si dhe; Qendra e Arbitrazhit e Dhomës së Tregtisë në Stamboll e themeluar në vitin 1979, që merret me kontestet e brendshme si edhe ato ndërkombëtare. Turqia është palë nënshkruese e Konventës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve - ICSID dhe palë në Marrëveshje të shumta bilaterale me vendet e tjera që parashikojnë arbitrazhin nën ICSID, me të vetmin qëllim që të inkurajohen investitorët e huaj të investojnë në Turqi.

6.2.Zgjidhja e kontesteve përmes mediacionit

Mediacioni është në zhvillim e sipër në Turqi dhe konsiderohet si një shans për palët për të zgjidhur kontestet në pajtim me ligjin turk. Mediacioni po bëhet, hap pas hapi, një fazë e detyrueshme në degë të ndryshme të sistemit gjyqësor turk. Mediacioni së pari u bë i detyrueshëm për kontestet në lidhje me ligjin e punësimit në fillim të vitit 2018. Pastaj, ai u bë një hap i detyrueshëm për pretendimet monetare tregtare që nga 1 janari 2019. Prandaj, palët duhet së pari të aplikojnë për mediacion; përndryshe, çështja do të pushohet për arsye procedurale pa shqyrtuar më tej bazueshmërinë e saj. Shkalla e suksesit është 97% në mediacion vullnetar. Si pjesë e përpjekjeve për të promovuar mediacionin vullnetar në dukje të suksesshëm, në 7 Gusht 2019, Turqia nënshkroi Konventën e Kombeve të Bashkuara për Marrëveshjet Ndërkombëtare të Zgjidhjes që Rezultojnë nga Mediacioni (Konventa e Singaporit për Mediacion), e cila siguron zbatueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare⁶².

7.Emiratet e Bashkuara Arabe

Ligji Federal i viti 2018, përfaqëson një zhvillim të madh në fushën e arbitrazhit ndërkombëtar për Emiratet e Bashkuara Arabe. Legjislacioni i ri është në përputhje me Ligjin Model UNCITRAL mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Ligji i Arbitrazhit është i zbatueshëm në arbitrazhet e ndonjë nga shtatë Emiratet që përbëjnë Emiratet e Bashkuara Arabe. Sidoqoftë, nuk zbatohet kur selia e arbitrazhit është Qendra Ndërkombëtare Financiare e Dubait- DIFC. Ligji i Arbitrazhit në Emiratet e Bashkuara Arabe përmban dispozita të kufizuara në lidhje me aspektet procedurale të arbitrazhit. Përndryshe, palët janë të lira të bien dakord për një procedurë të

⁶² Litigation & Dispute resolution, Turkey, Retrieved 30 August 2020 from :<https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/litigation-and-dispute-resolution-laws-and-regulations/turkey>.

përshtatshme për kryerjen e arbitrazhit në përputhje me nenin 23 të saj. E drejta e tillë përfshin të drejtën për t'iu nënshtruar rregullave institucionale të çdo qendre apo institucioni arbitrazhi⁶³.

8. Shtetet e bashkuara të Amerikës

Shtetet e Bashkuara janë një bashkim federal i 50 shteteve. Shtetet i kanë deleguar disa kompetenca qeverisë federale në përputhje me Kushtetutën e SHBA-së. Secili shtet ka sistemin e tij gjyqësor, i cili zakonisht përbëhet nga gjykata të shkallës së parë dhe gjykata të apelit. Ekziston një sistem paralel i gjykatave federale të krijuara në përputhje me Kushtetutën dhe statutet federale.

8.1. Zgjidhja e kontestit përmes arbitrazhit

SHBA është i favorshëm për arbitrazhin ndërkombëtar, pavarësisht nga madhësia e tij dhe sistemi i tij kompleksi juridik shtetëror. Statutet shtetërore të arbitrazhit dhe Ligjet pasqyrojnë politika të forta publike në favor të arbitrazhit, veçanërisht të arbitrazhit ndërkombëtar. Kjo politikë pro-arbitrazhit shprehet qartë, të cilën e zbatoi Konventa e Nju Yorkut dhe Panamasë. Në SHBA, palët janë të lira të zgjedhin mekanizmat dhe procedurat në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit. Në mënyrë domethënëse, disa shtete të SHBA kanë miratuar procedurat e parazgjedhura të arbitrazhit. Këto procedura zbatohen kur marrëveshja e arbitrazhit është e heshtur në lidhje me procedurat ose rregullat. Arizona, California dhe Texas janë ndër shtetet që kanë miratuar rregullat e parazgjedhura të arbitrazhit⁶⁴.

9. Kina

Kina është një nga shtetet më “mikpritëse” të investimeve në botë. Sa u përket kontesteve civile, gjykatat kineze kanë të theksuar gjithmonë mbrojtjen e barabartë të palëve, pa marrë parasysh se nga janë. Gjatë viteve 2013-2017 gjykatat zgjidhën rreth 15,000 konteste civile ndërkombëtare, gjykatat kineze kanë të theksuar gjithmonë mbrojtjen

⁶³ Litigation & Dispute resolution, United Arab Emirates, Retrieved 30 August 2020 from: <https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/international-arbitration-laws-and-regulations/united-arab-emirates>.

⁶⁴ Litigation & Dispute resolution, USA, Retrieved 20 September 2020 from: <https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/litigation-and-dispute-resolution-laws-and-regulations/usa>.

e barabartë të palëve, pa marrë parasysh se nga janë. Gjykatave kineze u është kërkuar që të përdorin plotësisht mënyrën elektronike në gjyqësor që nga fillimi i COVID-19. Nga 3 Shkurti deri më 20 Mars 2020, gjykatat zhvilluan gati 550,000 konteste online në të gjithë vendin, mbi 440,000 pagesa online, mbajtën mbi 110,000 seanca gjyqësore online dhe zhvilluan procedura mediacioni online më shumë se 200,000 raste. Numri i provave të shkëmbyera dhe dërgesave elektronike të bëra online ishin më shumë se 1.67 milion. Sipas Ligjit të Procedurës Civile të Kinës, është e mundur të zbatohen gjykimet e huaja në Kinë në përputhje me marrëveshjet e zbatueshme ose parimin e reciprocitetit. Kina ende nuk ka hyrë në marrëveshjet për njohjen dhe zbatimin e gjykimeve me partnerët e saj kryesorë tregtarë dhe investues, duke përfshirë Australinë, Anglinë, Gjermaninë, Japoninë dhe SHBA-në, por ka hyrë në marrëveshje të tilla me rreth 30 vende të tjera.

9.1.Zgjidhja e kontesteve përmes arbitrazhit

Kina është nënshkruese e marrëveshjeve bilaterale për njohjen e ndërsjelltë dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit me Hong Kong nga viti 2000 dhe Macao nga viti 2007. Kina është një shtet kontraktues i Konventës për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve midis Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të Tjera, Konventa ICSID. Kina është nënshkruese e shumë Marrëveshjeve bilaterale të investimeve dhe Marrëveshje të tjera për investime. Dy fenomenët kritikë: nga njëra anë, rritja dinamike e ekonomisë së Kinës gjatë dekadave të fundit, që ka sjellë në mënyrë të pashmangshme me vete një vëllim të lartë kontestesh; dhe nga ana tjetër, zbatimi i Ligjit të Arbitrazhit të Republikës Popullore të Kinës i vitit 1994, dhe legjislacioni pasues kanë formuar një mjedis pro-arbitrazhi, i cili nga ana tjetër tërheq gjithnjë e më shumë palë për të zgjidhur kontestet përmes arbitrazhit në Kinë. Ligji i Arbitrazhit parashikon që marrëveshja e arbitrazhit nuk mund të bëhet në mënyrë verbale, por duhet të jetë me shkrim. Ligji për Kontratat i vitit 1999 në nenin 11, përcakton se “*me shkrim*” do të thotë një kontratë, letër ose mesazh elektronik që është në gjendje të shprehë përmbajtjen e saj në formë të shkruar⁶⁵.

10.Rusia

Në Federatën Ruse, palët në një kontest gëzojnë diskrecion të plotë në zgjedhjen e

⁶⁵ *Litigation&Dispute resolution, China, Retrieved 20 September 2020 from: <https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/international-arbitration-laws-and-regulations/china>.*

metodave për zgjidhje të kontesteve. Legjislacioni rus parasheh: procedurat gjyqësore, procedurat e arbitrazhit, procedurat e mediacionit si dhe pajtimin gjyqësor. Deri më sot, procedurat gjyqësore dhe procedurat e arbitrazhit mbeten mënyrat e preferuara të zgjedhura nga palët për zgjidhjen e kontesteve.

10.1.Zgjidhja e kontesteve përmes arbitrazhit

Vetëm institucione të arbitrazhit që kanë marrë statusin zyrtar të përhershëm të arbitrazhit nga Ministria e Drejtësisë, mund të administrojnë procedurat e arbitrazhit në Rusi. Ligji Federal për Arbitrazhin, i vitit 2016, siguron kërkesa të rrepta për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të arbitrazhit me synimin që vetëm institucionet e arbitrazhit me të vërtetë profesionale dhe të pavarura të mund të udhëheqin arbitrazhin në Rusi. Palët zakonisht janë të lira të modelojnë kërkesën e tyre të arbitrazhit për t'iu përshtatur nevojave të tyre praktike, përfshirë numrin e arbitrave dhe procedurën për emërimin e tyre, vendin si dhe gjuhën e përdorur në procedurat e arbitrazhit. Legjislacioni rus i arbitrazhit nuk specifikon elementet e detyrueshme të një kërkesë arbitrazhi, përveç formës së shkruar të marrëveshjes, përfshirë dokumentet elektronike. Sipas legjislacionit procedural rus, gjykatat e shtetit mund të ndihmojnë arbitrazhin me seli në Rusi. Gjykatat gjithashtu janë kompetente në përfundimin e mandatit të arbitrave, të cilët nuk japin dorëheqje vullnetarisht për shkak të paaftësive të tyre, ose të cilët nuk arrijn të marrin pjesë në arbitrazh, nga vonesat e panevojshme të tyre si dhe atëherë kur palët nuk mund të bien dakord për përjashtimin e tij.

10.2.Zgjidhja e kontesteve përmes mediacionit

Mediacioni në Rusi rregullohet nga Ligji Federal i cili ka hyri në fuqi më 1 janar 2011. Thelbi i mediacionit është i njohur mirë: palët, të cilat nuk dëshirojnë të zgjidhin kontestin e tyre përmes gjykatës, përmes arbitrazhit, ose përmes mënyrës paqësore përmes pajtimit, referojnë kontestin tek një ndërmjetës-mediator, i cili merret me negociatat dhe procedurat e tjera të nevojshme për palët për të gjetur një zgjidhje të duhur. Baza e mediacionit rus është parimi i ndërmjetësimit lehtësues. Gjykata nuk mund t'i detyrojë palët t'i drejtohen mediacionit, procedura është vullnetare.. Mediatori mund të ketë statusin e një mediatori profesional ose jo-profesional. Çdo person që është mbi 25 vjeç, ka një arsim të lartë dhe ka kaluar trajnime të mediatorëve, mund të marrë statusin e një mediatori profesional⁶⁶.

⁶⁶ *Litigation&Dispute resolution, Russia, 29 August 2020 from: <https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/litigation-and-dispute-resolution-laws-and-regulations/russia>.*

II.ZGJIDHJA E KONTESTEVE INVESTUESE SIPAS DISA ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE

1.MIGGA

MIGA është agjension financiar ndërkombëtar i cili ofron siguri politike dhe sigurime për rritjen e kredisë. Këto siguri ndihmojnë investitorët për të mbrojtur investimet e huaja direkte kundër rreziqeve politike dhe jotregtare në vendet në zhvillim⁶⁷. Ofrojnë të drejta dhe siguri për investitorët e huaj që ata dhe investimet e tyre do të mbrohen dhe do të trajtohen në mënyrë të drejtë si dhe në pajtim të plotë me parimin e sundimit të ligjit, standardet dhe praktikat e pranura ndërkombëtare. Pra, Miga siguron investime ndërkombëtare. Kjo përfshinë investime të reja si dhe investimet që lidhen me zgjerimin, modernizimin, përmirësimin ose rritjen e projekteve ekzistuese, ose ku investitori demonstroi përfitimet e zhvillimit afatgjatë për projektin.

Veprimtaria e Agjensionit multilateral për sigurimin e investimeve është e rregulluar me rregulla ndërkombëtare, ligje të shteteve anëtare, me konventë, sipas së cilës në nenin 4 parasheh që Agjensionit mund ti bashkangjiten të gjitha shtetet anëtare të Bankës ndërkombëtare si dhe shteti Zvicëran⁶⁸.

Agjensioni multilateral për sigurimin e investimeve mbetet i përkushtuar për të lehtësuar investimet e huaja edhe në vend duke bashkëpunuar me Bankën Botërore për të maksimizuar kështu zhvillimin e Grupit të Bankës Botërore edhe në Maqedoninë e Veriut. Agjensioni vazhdon të mbetet i përqendruar në mobilizimin e investimeve të huaja private në fushat kryesore të ekonomisë përmes garansioneve të saja të sigurimit kundër rreziqeve politike dhe garansioneve të kredisë. Në mënyrë të veçantë, në sektorin financiar, agjensioni ofron mundësi të shpronësimit për mbulim të fondeve për bankat ndërkombëtare, për të lehtësuar dhe përshpejtuar hyrjen në kredi. Duke ulur shpalljen e rrezikut në sektorin bankar, mbulesa mbështet rritjen më të shpejtë të kredisë, aktivitetin ekonomik dhe punësimin. Në fund të shkurtit 2019, ekspozimi bruto i agjensionit në Maqedoninë e Veriut

⁶⁷ World Bank Group, 2019

⁶⁸ Neni 4, Konventa e MIGA-së.

arriti në 28 milion dollarë, i përqendruar në projektin e shpronësimit të fondeve ⁶⁹.

1.1.Themelimi

Më 12 Prill të vitit 1988 u themelua MIGA si anëtarja më e re në Grupin e Bankës Botërore. Agjensioni u hap si një njësi e pavarur ligjërish dhe e pavarur financiarisht. Agjensioni filloi me kapital prej 1 miliard dollarësh. Fillimisht shtetet anëtarë të MIGA-së ishin:

Bahreini; Bangladeshi; Barbados; Kanada; Kili; Qipro; Danimarka; Ekuadori; Egjipti; Gjermania; Grenada; Indonezia; Xhamajk; Japonia; Jordania; Korea; Kuvajti; Lesoto; Malavi; Hollanda; Nigeria; Pakistani; Samoa; Arabia Saudite; Senegal; Suedi; Zvicër; Mbretëri e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

MIGA u krijua për të plotësuar burimet publike dhe private të sigurimit të investimeve kundër rreziqeve jo-komerciale në vendet në zhvillim. Karakteri shumëpalësh i MIGA-s dhe sponsorizimi i përbashkët nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim u pa se rrisin ndjeshëm besimin midis investitorëve ndërkombëtarë.

Sot, misioni i MIGA është i drejtpërdrejtë:

- Të promovojë investime të huaja direkte në vendet në zhvillim;
- Të mbështesë rritjen ekonomike;
- Të zvogëloj e varfërinë dhe
- Të përmirësoj jetën e njerëzve ⁷⁰.

⁶⁹ Miga's impact, 2019

⁷⁰ Miga history, 2020

1.2. Inicimi i procedurës

Inicimi i procedurës bëhet nga investitorët nëpërmjet një aplikimi paraprake. Palët apo siç i njih agjensioni *aplikantët* paraqesin: së pari, kërkesë. Miga, në afat prej tre ditësh përcakton nëse kërkesa në parim është e pranueshme; Ata regjistrojnë kërkesën dhe i dërgojnë aplikuesit konfirmimin e regjistrimit, së bashku me një kërkesë përfundimtare, në të cilën aplikantit i kërkohet që të japë informacione më të detajuara. Në varësi të kompleksitetit të kërkesës, MIGA zakonisht lëshon garancion brenda tre deri në katër muaj për marrjen e një aplikimi përfundimtar. Nuk ka ndonjë pagesë për paraqitjen e një aplikimi paraprak, zakonisht vetë MIGA paguan një tarifë për regjistrimet përfundimtare. Nëse ofrohet dhe pranohet një garancion, tarifa kreditohet drejt pagesës së parë premium, në qoftë se MIGA dakordohet për të ofruar mbulimin, pagesa është e rimbursuar. Në qoftë se investitori vendos të mos blejë mbulimin, atëher MIGA mban tarifën. Gjithashtu MIGA mund të vendos për një tarifë shtesë veçanërisht për aplikimet komplekse dhe një tarifë për rregullimin e shumës shtesë, mbi mbulimin sipas rregulloreve të saja.

1.3 Zhvillimi dhe përfundimi i procedurës

Në qoftë se agjensioni dhe shteti vendas nuk kanë lidhur një marrëveshje për zgjidhjen e kontestit, agjensioni do të ndjekë procedurën e përcaktuar si në vazhdim: agjensioni së pari, do t'i kërkojë shtetit vendas të fillojë negociatat për zgjidhje, në përputhje me nenin 2 të shtojcës II të Konventës Miga. Agjensioni në asnjë rast nuk duhet të fillojë pajtimin ose procedurat e arbitrazhit para skadimit të një periudhe prej njëqind e njëzet ditësh nga data e kërkesës për të hyrë në negociata. Agjensioni mund të zgjasë negociatat për një periudhë të arsyeshme nëse i duket se kjo do të lehtësonte zgjidhjen e kontestit. Duhet të përgjigjet pozitivisht ndaj kërkesës së shtetit vendas për pajtim para se të paraqesë kontestin në arbitrazh. Agjensioni do të propozojë pajtimin, aq herë sa pajtimi mund të dërgojë në një zgjidhje, por do të sugjerojë edhe për përgatitje gjatë gjithë kohës për negociata, në një procedurë të mundshëm arbitrazhi⁷¹.

⁷¹ Operational Policies MIGA, 2015

Investitorë të kualifikuar që mund të kenë të drejtë të marrin garancionin e agjensionit, konsiderohen çdo person fizik dhe çdo person juridik që plotësojnë kushtet e përcaktuara: personi fizik të jetë shtetas i një anëtar tjetër përveç vendit investues; personi juridik të jetë inkorporuar dhe të ketë vendndodhjen e investimit në një anëtar ose shumica e kapitalit të tij të jetë në pronësi të një anëtar tjetër ose anëtare të shtetit të saj, me kusht që anëtar i tillë të mos jetë vendi investues në asnjë nga rastet e mësipërme; dhe personi i tillë juridik, pavarësisht nëse është apo jo në pronësi private; në rast se investitori ka më shumë se një shtetësi ⁷².

Nenin 23 i Konventës së Miga-së, parashikon edhe promovimin e investimeve, sipas së njëjtës: Agjensioni realizon kërkime, ndërmer aktivitete për tërheqjen e investimeve dhe shpërndan informacione mbi mundësitë e investimeve në vendet anëtare. Qëllimi i saj është përmirësimi i mjedisit për vijimin e investimeve të huaja në vende të tilla. Agjensioni, me kërkesën e anëtarëve të saj, ofron edhe këshilla teknike dhe asistencë për të përmirësuar kushtet e investimit në territoret e tyre. Në realizimin e këtyre aktiviteteve, agjensioni udhëhiqet nga marrëveshjet për investime në mes vendeve anëtare; në bazë të cilave kërkon: heqjen e pengesave në vendet e zhvilluara dhe në zhvillim, heqjen e pengesave në vijimin e investimeve në vendet anëtare të saja. Gjithashtu si anëtare e grupit të Bankës Botërore, MIGA siguron një ombrellë parandalimi kundër veprimeve të qeverisë, të cilët mund të pengojnë investimet e siguruara, Miga ndihmon në zgjidhjen e kontesteve të mundshme të palëve. Deri më sot, Miga ka qenë në gjendje të zgjidhë kontestet të shumta. Në fakt agjensioni arrin besimin e investorëve në lidhje me sigurinë e investimeve të tyre.

Kontestet mund të lindin atëherë kur një investitor pretendon se shteti ka shkelur detyrimet kontraktuese, në investimin e tij. Nga ana tjetër, atëherë kur shteti pretendon se investitori ka shkelur detyrimet kontraktuese. Atëherë kur palët nuk mund të pajtohen se kush është në faj dhe për mënyrën se si duhet të kompensohet pala e pakënaqur. Miga përdor të ashtuquajturat "zyrat e mira", për të shqyrtuar përgjegjësitë e mundshme dhe për të ndihmuar palët të arrijnë në një përfundim që do të zgjidhte kontestin ndaj të dyja palëve. Nëse palët edhe atëherë nuk janë në gjendje të arrijnë një epilog për kontestin e tyre dhe

⁷² neni 13, Konventa Miga

kërkesa për kompensim është sjellë nga investitori nën garancioni të Miga-së, ata shqyrtojnë faktet e kontesteve dhe bëjnë një përcaktim më formal. Nëse Miga arrinë zgjidhje për investitorin e siguruar, ata edhe do të paguajnë kompensimin për të cilin investitori ka të drejtë nën garancion. Kjo sipas kushteve të Konventës së Migës, më pastaj ju lejohet të kërkojnë rimbursim të shpenzimeve nga shteti vendas.

2.ICSID

ICSID, është institucion i pavarur, i depolitizuar dhe efektiv i zgjidhjes së kontesteve. Disponueshmëria e saj për investorët dhe shtetet ndihmon në promovimin e investimeve ndërkombëtare duke siguruar besim në procesin e zgjidhjes së kontesteve. ICSID është një institucion ndërkombëtar autonom dhe, siç është theksuar, ka personalitet të veçantë juridik nga Banka Botërore. Ndërsa ka lidhje institucionale, ka arsye të rëndësishme që ICSID të mbetet e pavarur. Projektet dhe politikat e bankave nuk ndikojnë në rezultatin e kontesteve si dhe arbitrat janë ekspertë të pavarur.

Në të njëjtën kohë, ICSID është një pjesë e Bankës Botërore, e cila ka miratuar angazhime të gjëra publike. ICSID është krahu i vetëm i Bankës Botërore që nuk përmendet në politikën e kësaj të fundit për ndryshimin e klimës. Një nga prioritetet e reja të Bankës Botërore është ndërkombëtarizimi i politikave të saj të qëndrueshmërisë. Forume të tjera të pavarura brenda Bankës Botërore kanë hapur dyert e tyre për konsultime dhe riorganizimin e shqetësimeve mjedisore përmes operacioneve të tyre. Dikush mund të sugjerojë që ICSID, më shumë se çdo institucion tjetër arbitrazhi, duhet të konsiderojë ndryshimin e klimës si një faktor të rëndësishëm në funksionimin dhe mbështetjen e tij. Sidomos pasi ICSID reformon Rregullat e Arbitrazhit, ekziston hapësira e domosdoshme dhe institucionale për të marrë parasysh atë që mund të bëjë ICSID për të shqyrtuar më tej shqetësimet e ndryshimeve klimatike, si dhe për zgjidhjet e mëtejshme të këtyre shqetësimeve⁷³. Konventa e ICSID siguron makineri të vetë arbitrazhit që veprojnë në pavarësi totale nga ligjet e

⁷³ M. Wendy, M. Lawry, *Arbitral Institutions and the Enforcement of Climate Change Obligations for the Benefit of All Stakeholders: The Role of ICSID*, 2019.

brendshme, përfshirë ligjet që mbizotërojnë në selinë e arbitrazhit⁷⁴.

2.1. Themelimi

ICSID u themelua në vitin 1966 nga Konventa për zgjidhjen e kontesteve të Investimeve mes shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera (Konventa ICSID). Konventa ICSID është një marrëveshje multilaterale e formuluar nga drejtorët ekzekutivë të Bankës Botërore, kështu për të çuar më tej objektivin e bankës për promovimin e investimeve ndërkombëtare ⁷⁵.

Jurisprudenca nën Qendrën ndërkombëtare për zgjidhjen e kontesteve të investimeve tani arrin më shumë se 30 vite. Që nga ajo kohë, ligji dhe praktikat e saja kanë evoluar në mënyrë të konsiderueshme. Tani kanë kompetenc për pothuajse të gjitha çështjet, duke filluar nga pikat kryesore themelore dhe procedurale, përfshirë afatin kohor, sfidat dhe zbatueshmërin e procedurës së kundërshtimit të arbitrit tek anëtarët e komisioneve ad hoc deri te standardi që duhet të plotësohet për të garantuar heqjen e një arbitër⁷⁶.

ICSID parasheh zgjidhjen e kontesteve përmes pajtimit, arbitrazhit ose gjetjes së fakteve. Procedura e ICSID është krijuar për të marrë parasysh karakteristikat e veçanta të kontesteve të investimeve ndërkombëtare dhe palëve të përfshira në të, duke ruajtur një ekuilibër në mes interesave të investitorëve dhe shteteve vendase. Secila çështje shqyrtohet nga komisioni i pavarur i pajtimit ose gjykata e arbitrazhit, pasi që ti kenë dëgjuar provat dhe argumentet ligjore nga palët. Një ekip i dedikuar i çështjeve ICSID përcaktohet për secilin rast për të ofruar ndihmëekspertëve gjatë gjithë procedurës⁷⁷. Deri më sot janë administruar më shumë se 700 raste të tilla nga ICSID ⁷⁸.

⁷⁴ G. R. Delaume, *Foreign Sovereign Immunity: Impact on Arbitration*, 1983.

⁷⁵ *Foreign investment law journal*, 2019.

⁷⁶ S. Luttrell, *Testing the ICSID Framework for Arbitrator Challenges*, 2016.

⁷⁷ *ICSID Review*, 2019

⁷⁸ Retrieved 10 April 2020 from: <https://icsid.worldbank.org/About/ICSID>.

2.2. Inicimi i procedurës

Inicimi i procedurës mund të bëhet bashkërisht nga palët në kontest ⁷⁹. Në kuadër të Konventës së ICSID, në nenin 36 paragrafin 1 dhe 2 parashihet që “Shteti kontraktues ose ndonjë shtetas i një shteti kontraktues që dëshiron të fillojë një procedurë arbitrazhi do t'i paraqesë një kërkesë me shkrim sekretarit të përgjithshëm, i cili më pastaj do t'i dërgojë një kopje të kërkesës palës tjetër”...“Kërkesa përmban informacione për çështjet në kontest, identitetin e palëve dhe pëlqimin e tyre për arbitrazhin në përputhje me rregullat e procedurës për krijimin e pajtimit dhe procedurave të arbitrazhit” ⁸⁰.

Sapo të regjistrohet kontesti, qendra ndërkombëtare për zgjidhjen e kontesteve krijon një llogari ruajtëse interesi për kontestin në fjalë. Kërkesat për fonde në këtë rast bëhen nga sekretariati ICSID dhe drejtohen nga Rregulloret administrative dhe Financiare të qendrës. Sipas Rregullores në nenin 14 alineja 3, palët bëjnë një paradhënie fillestare që në momentin e përcaktimit të gjykatës, e cila paguhet para seancës së parë. Prandaj, palët duhet të jenë të përgatitura për të avancuar fondet relativisht shpejt pas regjistrimit të kërkesës. Më tej palët bëjnë pagesa paraprake periodike të bazuara në vlerësimet e kostove që do të bëhen nga rasti. Qendra ndërkombëtare për zgjidhjen e kontesteve ka të drejtë të mos ofroj shërbim në qoftë se nuk janë bërë pagesat e nevojshme.

Shuma e kërkesës për paradhënie mund të ndryshojë nga rasti në rast, dhe caktohet në konsultim me kryetarin e gjykatës, bazuar në shpenzimet e mundshme në 3 deri 6 muajt e ardhshëm. Në përgjithësi, avansi fillestar është zakonisht midis 100,000 - 200,000 dollarë për secilën palë, dhe kërkesa dërgohet menjëherë pas konstituimit të gjykatës. Nëse paradhëniet e kërkuara nuk paguhet në afat prej 30 ditësh, sekretari i përgjithshëm i ICSID informon palët për mospagimin dhe fton secilën palë të shlyej detyrimet. Nëse pagesa ende nuk shlyhet brenda 15 ditëve, sekretari i përgjithshëm mund t'i kërkojë gjykatës të anulohet procedurën e cila mund të çojë në pushimin e çështjes⁸¹.

⁷⁹ Neni 2, *Rregullat shtesë të ICSID*.

⁸⁰ Neni 3, *Konventa e ICSID*.

⁸¹ *ICSID Review*, 2019


Gjatë inicimit të një procedure për arbitrazh palët duhet të jenë të vetëdijshme për procedurat e ardhshme dhe të jenë të gatshëm t'i adresojnë dhe ndjekin fazat e paraqitura në tabelën në vazhdim:

Tabela 1: Fazat procedurale gjatë inicimit të një procedure në arbitrazhin e ICSID të paraqitura skematikisht



Burimi: Punimi i autores i bazuar në të dhënat e ICSID, 2020

Mjetet juridike të lejuara pas shpërblimit:



2.3 Zhvillimi dhe përfundimi i procedurës

Duke u bazuar në nenin 44 të *Konventës së ICSID*, parashihet që procedura duhet të zhvillohet në pajtim me dispozitat e kësaj konvente vetëm nëse palët nuk merren vesh ndryshe, në pajtim me Rregullat shtesë në fuqi, procedura zhvillohet në momentin kur palët merren vesh. Nëse paraqitet çështje procedurale që nuk është e përfshirë në Konventë apo në Rregullat shtesë atëherë vendos gjykata. Sipas Rregullave të Arbitrazhit, gjykata duhet të mbajë seancën e parë brenda 60 ditëve pas konstituimit të saj. Megjithëse kjo periudhë mund të zgjatet me marrëveshje të palëve, ICSID kërkon të caktojë seancën e parë sa më shpejt të jetë e mundur brenda 60 ditëve për të shpejtuar procedurat⁸². Seanca e parë e gjykatës është një takim procedural për të vendosur mbi sjelljen e arbitrazhit. Mund të bëhet personalisht, përmes telefonit ose videokonferencës, në mënyrë që të kursejn kosto dhe të thjeshtohet procedura. Palët shpesh bien dakord që të mbajnë një seancë të parë përmes telefonit ose videokonferencës, atëherë kur ka më pak pikapër tu diskutuar në rendin e ditës⁸³.

Para seancës së parë, sekretariati i ICSID lëshon projekt agjendën, ku rënditen pikat që do të diskutohen nga palët. Këto përfshijnë rregullat e zbatueshme të arbitrazhit, kostot e arbitrazhit, kohën për secilën fazë të procedurës, çështjet procedurale që rregullojnë fazën me shkrim dhe verbale të procedurës dhe trajtimin e provave. Sekretariati gjithashtu u siguron palëve një urdhër procedural, duke u kërkuar atyre të tregojnë pikat për të cilët dakordoheni dhe pikat për të cilët palët nuk dakordohen. Në seancën e parë, kryetari i gjykatëskalton nëpër pikat e rendit të ditës, duke u dhënë palëve mundësin për të konfirmuar qëndrimet e tyre përkatëse për secilën pikë. Çështjet e kontestit që mbeten mes palëve vendosen nga gjykata pas konsultimit midis anëtarëve të tij. Pas seancës së parë, gjykata lëshon një urdhër procedural që përcakton marrëveshjen e palëve dhe vendimet e gjykatës mbi pikat e ndryshme të rendit të ditës.

⁸² Neni 13, Rregullat e arbitrazhit

⁸³ Neni 21, Ibid

Fillimi i çështjes, afatet e detyrueshme kohore përcaktohen në urdhrin e parë procedural. Urdhri procedural duhet të planifikojë aq larg sa është e mundur për të siguruar që palët dhe gjykata të rezervojnë kohën e nevojshme dhe të shmangin detyrimin e kthimit në gjykat për të caktuar data të tjera. Palët zakonisht "planifikojnë prapa" nga afatet kohore të detyrueshme për t'u siguruar që ato përputhen me orarin.

Procedurat e ICSID mund të mbahen në çdo rajon të botës. ICSID ka lehtësi të mëdha dëgjimi në selinë e Bankës Botërore në Uashington, dhe Qendrën e Konferencave të Bankës Botërore në Paris. Për më tepër, ICSID ka qasje në lehtësirat në zyrat e tjera të Bankës Botërore ose bazuar në marrëveshjet me institucionet e tjera të arbitrazhit. Vendi nuk ka lidhje me zbatueshmërinë e çmimit të lëshuar sipas Konventës ICSID. Kjo është në kontrast me çmimet e lëshuara në bazë të Rregullave të Arbitrazhit dhe Rregullave të United Nation Commission on International Trade Law- UNCITRAL (*Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare*) ku selia ligjore e arbitrazhit përcakton vendin dhe disponueshmërinë e rishikimit të vendimeve dhe vendimeve.

Sa i përket gjuhës së përdorur në procedurë, ICSID ka tre gjuhët e saja zyrtare: anglisht, frëngjisht dhe spanjisht. Janë vetë palët ata të cilët kërkojnë nga sekretariati i ICSID në lidhje me gjuhën të cilën e dëshirojnë në seancën e parë ose gjuha do të caktohet nga vetë gjykata. Në fakt, nga palët duhet të jetë në konsiderat edhe pjesa buxhetore, që përfshin përkthimete nevojshme të dokumenteve, nga përkthyes. Këto shpenzime paguhen nga vetë palët ⁸⁴.

3. Arbitrazhi ndërkombëtar

Arbitrazhi ndërkombëtar, ju jep të drejtën palëve që vijnë nga vende të ndryshme, që flasin gjuhë të ndryshme të zgjidhin kontestet në mënyrë përfundimtare, pa mos u detyruar t'u binden sistemeve të tyre ligjore. Arbitrazhi ndërkombëtar bazohet në kontratë, ligje të selisë së arbitrazhit, konventës së New Yorkut dhe Washingtonit, e njohur si Konventa e ICSID.

⁸⁴ Neni 30, Rregullat e arbitrazhit.

Në literatura të ndryshme, termi *arbitrazh ndërkombëtar* nuk është edhe aq saktë i definuar. Sidoqoftë, ekziston qartësia për elementet përbërëse të saj. Më e rëndësishmja këtu është vetë arbitrazhi. Pra edhe arbitrazhi ndërkombëtar, është një procedurë e zgjidhjes së kontesteve që, ashtu si çështjet gjyqësore në gjykatat e shtetit, dërgon në një rezultat përfundimtar dhe detyrues. Dallimi kryesor në mes arbitrazhit dhe procedurës gjyqësor është se arbitrazhi është konsensual dhe vendimi përfundimtar vlen vetëm tek ato çështje të referuara nga palët në arbitrazh.

Arbitrazhi ndërkombëtar mbështetet në rregullat e institucioneve ndërkombëtare të:

Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar të Londrës - LCIA;
Qendrës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Hong Kongut - HKIAC;
Qendrës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Singaporit – SIAC;
Qendrës Ndërkombëtare të Zgjidhjes së kontesteve investuese-ICSID;
Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen të kontesteve të Shoqatës Amerikane të Arbitrazhit – ICDR;
Dhomës së Tregtisë së Stokholmit – SCC;
Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën Ndërkombëtare të Tregtisë – UNCITRAL;
Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë – ICC.

Burimi: *Aceris Law, 2020*⁸⁵.

3.1 Themelimi

Vlenë të theksojm se në fillimet e themelimit, shumë vende nuk i njihnin vendimet e arbitrazhit. Në atë kohë, një procedurë arbitrazhi për zgjidhje të kontesteve nuk ishte edhe aq e vlefshme. Ishte gjithashtu e zakonshme që, edhe në vendet në të cilat procedura e arbitrazhit ishte e vlefshme, ajo shpesh nuk e ndalonte gjykatën e vendit që të marrë një vendim tjetër mbi kontestin, pavarësisht në qoftë se procedura kishte filluar në gjykatë arbitrazhi⁸⁶.

⁸⁵ Retrieved 15 Maj 2019 from: <https://www.acerislaw.com>.

⁸⁶ *United Nations, 2005*

Më pastaj, në vitin 1899 në Konferencën e Hagës, e cila miratoi edhe *Konventën e Hagës për zgjidhjen paqësore të kontesteve ndërkombëtare*, deklaruan që: Arbitrazhi ndërkombëtar të kishte për objekt zgjidhjen e kontestevemes shteteve nga gjyqtarët sipas zgjedhjes së tyre dhe në bazë të respektimit të ligjit⁸⁷.

Gjykata ndërkombëtare e arbitrazhit është institucioni kryesor i arbitrazhit në botë. Arbitrazhi ndërkombëtar siç e njohim sot filloi në Evropën Kontinentale në vitet 1920⁸⁸. Rastet e para u zhvilluan rreth tetëdhjetë vjet më parë, në vitin 1923. Që nga viti 1923, jep kontributin e saj në zgjidhjen e vështirësive në kontestet ndërkombëtare si dhe mbështet investimet. Gjithnjë e më shumë, arbitrazhet ndërkombëtare përfshijnë kombinime të ndryshme të palëve, qoftë personave juridik ose personave fizik.

3.2 Inicimi i procedurës

Në bazë të rregullave, pala paditës duhet që të paraqesë kërkesën për arbitrazh, në ndonjë nga zyrat përkatëse të përcaktuara në rregullore. Në vazhdim sekretariati përgjegjës njofton palën paditës dhe të paditurin për marrjen e kërkesës dhe datën. Data në të cilën pranohet kërkesa nga ana e sekretariatit, konsiderohet të jetë data e fillimit të procedurës së arbitrazhit. Kërkesa duhet të përmbajë informacionet si në vijim:

- emrin e plotë, adresën dhe detajet e tjera kontaktuese të secilës palë;
- emrin e plotë, adresën dhe detajet e tjera kontaktuesetë personave që përfaqësojnë paditësin në arbitrazh;
- përshkrim të natyrës dhe rrethanave të kontestit, që shkakton pretendimet si dhe baza mbi të cilën bëhen këto pretendime;
- deklaratë të lehtësimit të kërkuar, së bashku me shumat e çdo pretendimi dhe, për aq sa është e mundur, një vlerësim të vlerës monetare të kërkesës;
- çdo marrëveshje përkatëse dhe, në veçanti, marrëveshjen/et e arbitrazhit;
- të gjitha veçoritë përkatëse dhe çdo vërejtje ose propozim në lidhje me numrin e arbitrave dhe zgjedhjen e tyre në përputhje me dispozitat e neneve 12 dhe 13; dhe
- të gjitha veçoritë përkatëse dhe çdo vërejtje ose propozim në lidhje me vendin e

⁸⁷ Ibid, 2005

⁸⁸ Ibid.

arbitrazhit, rregullat e zbatueshme të ligjit dhe gjuhën e arbitrazhit ⁸⁹.

Pala paditëse mund të paraqesë dokumente ose informacione të tjera bashkë me kërkesën, siç i konsideron të përshtatshme ose që mund të kontribuojnë në zgjidhjen efikase të kontesteve. Në rast se pala paditëse nuk arrin të përmbushë asnjërën nga këto kërkesa, sekretariati mund të caktojë një afat kohor brenda të cilit paditësi duhet të përmbushë, duke mos arritur që dosja të mbyllet pa cenuar të drejtën e paditësit për të paraqitur të njëjtat pretendime më vonë në një kërkesë tjetër⁹⁰.

3.3 Zhvillimi dhe përfundimi i procedurës

Procedura në arbitrazh është fleksibile, që do të thotë është procedurë që ndryshon në varësi të përshtatjes me llojin e kontestit që ka të bëjë. Për shembull:

Shembulli 5:

Një procedurë arbitrazh në lidhje me cilësinë e një malli të caktuar të dorëzuar me kontratë shitje, nuk kërkon të njëjtat procedura ashtu sikurse procedura e një arbitrazhi në lidhje me ndërtimin e një fabrike.

Fleksibiliteti i procedurës është i një rëndësie të veçantë në arbitrazhin ndërkombëtar, si dhe një avantazh për arbitrazhet vendase.

Zhvillimi i procedurës mund të jetë me urdhër nga gjykata e arbitrazhit sipas detyrës zyrtare ose në varësi të kërkesës së palëve.

Aspekt tjetër me rëndësi gjatë procedurës është edhe ekspertiza, si një mjet prove që palët ose gjykata e arbitrazhit mund të përdorin në rast se ekziston nevoja për të sqaruar rrethana të caktuara faktike me njohuri më të specializuara në fusha të veçanta. Gjukata e arbitrazhit ka mundësinë, përveç nëse palët bien dakord ndryshe, të caktojë një ose më shumë ekspertë për të përgatitur një raport, për çështje të caktuara. Sipas rregullave të *Uncitral*: gjykata e arbitrazhit, pas konsultimit me palët, mund të caktojë një ose më shumë ekspertë të pavarur për t'i raportuar, me shkrim, për çështje specifike që do të përcaktohen nga gjykata e arbitrazhit“. Palët do t'i sigurojnë ekspertit të gjitha informacionet e

⁸⁹ Retrieved 19 Januar 2020 from: <https://iccwbo.org/dispute-resolution-services/arbitration/rules-of-arbitration/>.

⁹⁰ Rules of Arbitration, 2017.

nevojshme, duke përfshirë dokumentet ose mallrat përkatëse që duhet të hetohen. Pas përgatitjes së raportit me shkrim ose verbalisht, është mundësia e dëgjimit të ekspertit, me kërkesën e njëres palëose të gjykatës së arbitrazhit. Para se të pranojnë emërimin e tyre, ekspertët do t'i komunikojnë gjykatës së arbitrazhit dhe palëve një përshkrim të kualifikimeve që ata mbajnë dhe një deklaratë në lidhje me pavarësinë dhe paanësinë e tyre. Brenda kohës së urdhëruar nga gjykata e arbitrazhit, palët do të nxjerrin çdo kundërshtim në lidhje me kualifikimet, paanshmërinë ose pavarësinë e ekspertit dhe gjykata e arbitrazhit do të vendosë menjëherë nëse do të pranojë kundërshtime të tilla. Pas emërimit të arbitrave, një palë mund të kundërshtojë vetëm nëse arsyet dihen prej saj më pas. Që të përfundojnë ekspertizën, palët do t'i japin ekspertit çdo informacion përkatës ose të prodhojnë për inspektimin e tij ose të saj çdo dokument ose mall të rëndësishëm që ai ose ajo mund të kërkojë prej tyre. Çdo mosmarrëveshje në mes palës dhe ekspertit në lidhje me rëndësinë e informacionit të kërkuar do t'i referohet gjykatës të arbitrazhit për vendim. Pas marrjes së raportit të ekspertit, gjykata e arbitrazhit do t'u komunikojë një kopje të raportit palëve në mënyrë që ata të shprehin me shkrim mendimin e tyre. Palët kanë të drejtë të shqyrtojnë çdo dokument në të cilin eksperti është mbështetur në raportin e tij ose të saj. Gjithashtu, pas dorëzimit të raportit, me kërkesë të secilës palë, eksperti mund të dëgjohet në seancë dëgjimore, ku palët do të kenë mundësinë të marrin në pyetje ekspertin⁹¹.

Prej kohësh arbitrazhi ndërkombëtar ofron një mekanizëm të shpejtë për zgjidhje të kontesteve nën një vlerë të caktuar. Në terma të përgjithshëm, ato ofrojnë kornizën procedurale për arbitrazhin nga fillimi në fund dhe, në veçanti, mbulojnë: fillimin e arbitrazhit, konstituimin e gjykatës, zhvillimin e procedurave, dhënien e vendimeve dhe përcaktimin e shpenzimeve. Procedurat, edhe pse të ndryshme, në mënyrë tipike u ofrojnë palëve një mundësi për të paraqitur çështjen e tyre përmes parashtresave me shkrim së bashku me çdo provë dokumentare, faktike dhe eksperte.

Gjithashtu, ka mundësi që të zhvillohen seanca dëgjimore ndërmjetësuese që palët të mund të bien dakor, për oraret dhe seancat të tjera dëgjimore në vazhdimësi. Procedura e arbitrazhi zakonisht përfundon në seancën dëgjimore në vendin e zgjedhur ose në një vend tjetër nëse pajtohet nga palët. Shpenzimet dorëzohen brenda gjashtë muajve, megjithëse ky afat mund edhe të ndryshoj⁹².

⁹¹ Neni 29, *Uncitral*.

⁹² Retrieved 21 Prill 2020 from: <https://www.ashurst.com/en/news-and-insights/legal-updates/introduction-to-international-arbitration>.

Më tej, do të paraqesim disa nga avantazhet dhe dizavantazhet e arbitrazhit ndërkombëtar:

<i>Avantazhet</i>	<i>Dizavantazhet</i>
Zbatueshmëri e lartë ndër-juridiksionale e çmimeve; Fleksibilitet; Ekspertizë.	Kosto relativisht e lartë; Vonesa të mundëshme; Mungesa e parandalimit nga pala e tretë.

Akoma më tej, do të paraqesim një përmbledhje të avantazheve duke i veçuar si karakteristika të arbitrazhit ndërkombëtar:

<i>Karakteristika të arbitrazhit ndërkombëtar:</i>	
<i>Konsensual</i>	Arbitrazhi është një procedurë vullnetar dhe konsensual.
<i>Neutral</i>	Arbitrazhi ofron zgjidhjen e kontesteve në mënyrë neutrale.
<i>Zgjedhje</i>	Palët në një arbitrazh kanë zgjedhje të konsiderueshme në përcaktimin se si, ku, nga kush dhe në cilën gjuhë zgjidhet kontesti i tyre.
<i>Privatësi dhe konfidencialitet</i>	Arbitrazhi është veçanërisht i favorshëm për palët tregtare për shkak të privatësisë dhe konfidencialitetit që mund të ofrojë.
<i>Përfundim</i>	Shumica e ligjeve të arbitrazhit nuk lejojnë që vendimi të kundërshtohet përveç në rrethana shumë të kufizuara.
<i>Zbatueshmëri</i>	Lehtësia e zbatimit të vendimeve të arbitrazhit shihet si një avantazh kryesor i arbitrazhit.

KREU IV

TË DHËNA STATISTIKORE DHE RASTE NGA PRAKTIKA NË LIDHJE ME ZGJIDHJEN E KONTESTEVE INVESTUESE

Tabela 2. Zgjidhje e kontesteve nëpërmjet mediacionit gjatë muajit Gusht 18/19/20


Viti	Raste	Raste të përfunduara (përqindje)	Koha e përfundimit (ditë)
2020	283	405 (82%)	109
2019	372	402 (86%)	93
2018	352	504 (77%)	119
2020 vs 2019	-24%	+1%	+17%

Burimi: FINRA, 2020⁹³.

Tabela numër dy paraqet zgjidhjen e kontesteve gjatë muajit gusht për tre vitet e fundit, konkretisht vitin 2018, 2019 dhe 2020. Siç mund të shohim rastet të regjistruara për zgjidhje në procedure mediacioni dy vitet e fundit kanë patur një rritje, edhe pse viti 2020 në krahasim me vitin 2019 ka -24% të rasteve. Viti 2020 në thelb nuk duhet marrë edhe shumë për bazë sidomos në krahasime, pasi që është vit pandemie. Nga ana tjetër procedura të përfunduara në vitin 2018 kemi 82%, në vitin 2019 86%, dhe në vitin 2020 77%.

⁹³ Retrieved 20 September 2020 from: <https://www.finra.org/arbitration-mediation/dispute-resolution-statistics#mediationstats>.


Tabela 3: Rastet e regjistruara nga ICSID nën konventën ICSID dhe rregullat shtesë



Burimi: Icsid, Worldbank, 2020⁹⁴.

Nga 30 qershori 2019, ICSID kishte regjistruar 728 raste sipas Konventës ICSID dhe Rregullave shtesë.

Figura 1: Lloji i rasteve të regjistruara në ICSID



Rastet:

89.7% Arbitrazhit të Konventës ICSID

8.7% Arbitrazhit të Lehtësisë shtesë të ICSID

1.3% Pajtimit të Konventës ICSID

0.3% Pajtimit të objektit shtesë të ICSID

Burimi: Icsid statistics, 2020⁹⁵.


⁹⁴ Retrieved 20 September 2020 from:

<https://icsid.worldbank.org/sites/default/files/publications/The%20ICSID%20Caseload%20Statistics%20%282020-2%20Edition%29%20ENG.pdf>.

⁹⁵ Retrieved 20 September 2020 from:

<https://icsid.worldbank.org/sites/default/files/publications/The%20ICSID%20Caseload%20Statistics%20%282020-2%20Edition%29%20ENG.pdf>.

Tabela 4. Shpërndarja gjeografike e rasteve të regjistruara nën Konventën ICSID dhe rregullat shtesë të saj.



Burimi: ICSID, World Bank, 2019⁹⁶.

Njëzet e tre raste u inicuan kundër shtatëmbëdhjet shteteve të ndryshme nga Evropa Lindore dhe Azia Qendrore. Njëmbëdhjetë raste u inicuan kundër tetë shteteve të ndryshme nga Afrika Sub-Sahariane. Tetë raste u inicuan kundër pesë shteteve të ndryshme nga rajoni i Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut, shtatë raste përfshirë tre shtete në Amerikën e Jugut, tre raste u inicuan kundër tre shteteve të ndryshme në Azinë Jugore dhe Lindore dhe rajonin e Paqësorit. Dy shtete në Evropën Perëndimore u emëruan si përgjegjës në dy arbitrazhe të reja, dhe dy çështje u sollën kundër një shteti në Amerikën e Veriut. Një rast tjetër përfshiu një shtet në Amerikën Qendrore dhe Karaibet.

⁹⁶ Retrieved 19 Maj 2019 from: https://icsid.worldbank.org/sites/default/files/publications/annual-report/en/ICSID_AR18_Interior_English_CRA_web.pdf.

Tabela 5:Arbitrazhi virtual

Konteste në seanca virtuale	Të pranuar	Të refuzuara	Të hapura	Gjithësejt
Palë	41 (73)%	15 (27%)	14	70
Intra-industria	11 (55)	9 (45%)	3	23
Gjithësejt Palë dhe intra- industria	52 (68%)	24 (32%)	17	93


Burimi: Icsid, Worldbank. Shtator 2020 ⁹⁷.

Që nga fillimi i pandemisë Sars Covid2, pothuajse çdo aktivitet u shëndrua në “botën digjitale të internetit”, prezenca fizike u shëndrua në prezencë online. Seminaret i zëvendësoi webinari, konferencat- webkonferenca, kështu ndodhi edhe me procedurat e arbitrazhit. Në pamundësi përdëgjimetë palëve me prezencë fizike në seanca, ata vazhduan me seancat të ashtuquajturat “dëgjime virtuale”. Nga data 31 Gusht, u realizuan 45 raste të arbitrazhit në seanca dëgjimore nëpërmjet aplikacionit Zoom (19 raste të palëve dhe 26 raste të intra industrisë. Në total janë gjithësejt 93raste të përbashkëta në dëgjime virtuale (70 raste palë dhe 23 raste intra industrisë).

⁹⁷ Retrieved 20 September 2020 from:

<https://icsid.worldbank.org/sites/default/files/publications/The%20ICSID%20Caseload%20Statistics%20%282020-2%20Edition%29%20ENG.pdf>.

Figura 2: Marrëveshjet e zgjedhura në rastet e regjistruara nën Konventen e Icsid




Burimi: Icsid, Worldbank, Shtator 2019⁹⁸.

Nga tabela më lartë mund të shohim se si marrëveshje të zgjedhura nga palët dominojnë marrëveshjet bilaterale të investimeve me 60% të rasteve të regjistruara; 16% marrëveshje investimi midis investorit dhe shtetit nikoqir; 9 % marrëveshje e kartës së energjisë; 8% të rasteve të regjistruara në bazë të Ligjit mbi investime të shtetit nikoqir; 3 % marrëveshja e tregtisë së lirë e Amerikës së Veriut; 3% marrëveshje të tjera, ndërkajmë marrëveshja e regjistruar me vetëm 1 % të rasteve është marrëveshja e tregtisë së lirë e Republikës Dominikane dhe Shteteve të Bashkuara.

⁹⁸Retrieved 10 September 2019 from:

<https://icsid.worldbank.org/sites/default/files/publications/The%20ICSID%20Caseload%20Statistics%20%282020-2%20Edition%29%20ENG.pdf>.

Figura 3: Shpërndarja gjeografike e të gjitha rasteve të regjistruara në bazë të Konventës ICSID dhe Rregullat shtesë, nga shtetet e përfshirë



Burimi: Icsid statistics, Shtator 2020⁹⁹.

26%	Evropa Lindore dhe Azia Qendrore
23%	Amerika e Jugut
15%	Afrika Sub-Sahariane
11%	Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut
8%	Evropa Perëndimore
7%	Azia Jugore, Lindore dhe Paqësori
6%	Amerika Qendrore dhe Karaibet
4%	Amerika e Veriut (Kanada, Meksikë dhe SH.B.A.)

⁹⁹ Retrieved 20 September 2020 from:

<https://icsid.worldbank.org/sites/default/files/publications/The%20ICSID%20Caseload%20Statistics%20%282020-2%20Edition%29%20ENG.pdf>.

Tabela 6: Statistika historike për rastet e dështuara dhe rastet e përfunduara nëpërmjet procedurës së mediacionit gjatë 5 viteve të fundit 2015-2020

Viti	Raste të dështuara	Raste të përfunduara
2020	2657	2342
2019	3757	4011
2018	4325	3756
2017	3456	3735
2016	3681	3635
2015	3435	3489

Burimi: Dispute resolution, statistics. Shtator 2020¹⁰⁰.

Nga tabela mund të shohim se në vitin 2019 kemi patur një rekord rastesh të përfunduara nga procedura e mediacionit, gjithësejt 4011 raste, ndërsa më pak raste në vitin 2020 me 2342 raste të përfunduara. Në vitin 2018 ka patur plotë 3756 raste, në vitin 2017 3735 raste, në vitin 2016, 3635 raste, në vitin 2015, 3489 raste të përfunduara.

Sa u përket rasteve të dështuara, më shumë raste kemi në vitin 2018 me plotë 4325 raste të dështuara, ndërsa më pak raste në vitin 2020, me vetëm 2657 raste të dështuara.

¹⁰⁰Retrieved 20 September 2020 from: <https://www.finra.org/arbitration-mediation/dispute-resolution-statistics#historicalarbstats>.

RAST NGA PRAKTIKA: ICC Nr. 20564 / EMT

Viti: 2015

Palët: Hydro kundër Republikës së Shqipërisë

Statusi i rastit: Arbitrazh i përfunduar më datë 24 Prill 2019

Lloji i rastit: Marrëveshje ndërkombëtare për investime

Instrumenti ligjor: Kontratë

Rregullat e zbatueshme të arbitrazhit: Konventa ICSID dhe Rregullat e arbitrazhit

Marrëveshja e investimeve: Marrëveshja Bilaterale Shqipëri - Itali 1991

Spektori ekonomik: Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe kondicioner

Shteti mëmë/Shqipëria

Shteti investitorit/ Italia

Përmbledhje:

Rasti ka të bëjë mbi investimet e bëra në një hidrocentral në Kalivaç në jug të Shqipërisë, një strukturë për menaxhimin e mbetjeve si dhe stacionin televiziv Agonset.

Përmbledhje e kontestit

Veprimet qeveritare nga shteti i Shqipërisë, për të minuar investimet e paditësve, duke përfshirë procedurat e kontrollit tatimor, konfiskimin dhe sekuestrimin e llogarive dhe pasurive bankare, dhe urdhër-arrestet kundër paditësve individualë.

Zgjidhja e kontestit në këtë rast është kryer nga Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve ICSID. Në procedurën e arbitrazhit në një përbërje prej kryetarit të gjykatës Pryles, M. C., arbitri i zgjedhur nga paditësi, Poncet, C., dhe arbitri tjetër i zgjedhur nga i padituri në këtë rast shteti shqiptarë, Glick, I.

Gjatë shqyrtimit të rastit gjykata e arbitrazhit ka konstatuar shkelje të marrëveshjeve si: shpronësim (eksproprijim¹⁰¹) i drejtpërdrejtë. Ky kontest është zgjedhur në bazë të rregullave të arbitrazhit dhe rezultatet e procedurave janë vendosur në favor të investitorit. Vendim është marrë më datë 24 Prill 2019. Shuma e kompensimit e pretenduar nga investitori ka qenë 650.00 milion euro apo 728.40 milionëdollarë amerikan. Janë shpërblyer nga gjykata me 110.00 milion euro apo 123.60 milionëdollarë amerikan.¹⁰²

¹⁰¹Eksproprijimi nënkupton marrja e një të drejte pronësore nga personi privat. Pra, krijimi i një servituti nga ana e shtetit në një pronë të paluajtshme private.

¹⁰² Linku i rastit të plotë: <https://www.italaw.com/sites/default/files/case-documents/italaw7643.pdf>.

RAST NGA PRAKTIKA: ICSIDNr. ARB/09/16

Viti: 2009

Palët: Swisslion d.o.o kundër Maqedonisë së Veriut

Statusi i rastit: Arbitrazh i përfunduar më datë 24 Prill 2019

Lloji i rastit: Marrëveshje ndërkombëtare për investime

Instrumenti ligjor: Kontratë

Statusi i çështjes: Fazë e Arbitrazhit e Përfunduar më datë 6 qershor 2012

Rregullat e zbatueshme të arbitrazhit: Lehtësia shtesë e ICSID

Marrëveshjet e investimeve: Marrëveshja Bilaterale Maqedoni - Zvicër 1996; Marrëveshja Bilaterale Maqedoni-Serbi

Shteti mëmë/ Maqedonia e Veriut

Shteti investitorit/ Zvicra

Përmbledhje:

Rasti ka të bëjë me detaje investimi që ndeshen në kontest, në të cilën janë keqpërdorur aksionet. Aksionete një kompanie të zotëruar nga shoqëria maqedonase sipas marrëveshjes së caktuar të shitjes së aksioneve të lidhur me Ministrinë e Ekonomisë të Maqedonisë.

Përmbledhje e kontestit

Pretendimet që dalin për shitjen e aksioneve të lidhur nga një marrëveshje mes Swisslion dhe Maqedonisë së Veriut, ku sipas së cilës marrëveshje investitori fitoi një aksion kontrollues nga një kompani maqedonase e prodhimit të ushqimit e njohur si Agropold AD Resen, dhe masat e qeverisë dërguan në përfundimin e kësaj marrëveshjeje si dhe urdhëruan transferim të aksioneve të kompanisë Agropold në Ministrinë e Ekonomisë të Maqedonisë së Veriut.

Rasti në fjalë është zgjedhur nga Qendra ndërkombëtare për zgjidhjen e kontesteve. Me përbërje gjyqësore, kryetari i gjykatës Guillaume, G, arbitri i zgjedhur nga paditësi Price, D. M, arbitri tjetër i zgjedhur nga i padituri siç është në këtë rast Maqedonia e Veriut, Thomas, J. C.

Gjatë shqyrtimit të rastit gjykata e arbitrazhit ka konstatuar shkelje të marrëveshjeve si: shpronësim indirekt dhe janë konstatuar shkelje të tjera si: standard minimal i trajtimit të drejtë dhe të barabartë, duke përfshirë edhe mohimin e drejtësisë. Ky rast është vendosur

në favor të investitorit më datë 6 qershor 2012. Shuma e kompensimit e pretenduar nga investitori ka qenë 21.00 milioneuro ose 26.00 miliondollarë. Është shpërblyer nga gjykata me 0.35 milioneuro ose 0.43 miliondollarë amerikan¹⁰³.

¹⁰³Linku i rastit të plotë: http://icsidfiles.worldbank.org/icsid/ICSIDBLOBS/OnlineAwards/C740/DC2612_En.pdf.

RAST NGA PRAKTIKA: ICSID Nr. ARB / 12/39

Viti 2012

Palët: Georg Gavrilovic dhe Gavrilovic d.o.o. kundër Republikës së Kroacisë

Statusi i rastit: Arbitrazh i përfunduar më datë 26 Qershor 2018

Lloji i rastit: Marrëveshje ndërkombëtare për investime

Instrumenti ligjor: Kontratë

Rregullat e zbatueshme të arbitrazhit: Konventa ICSID dhe Rregullat e arbitrazhit

Marrëveshja e investimeve: Marrëveshja Bilaterale Austri - Kroaci (1997)

Shteti mëmë/ Kroacia

Shteti investitorit/ Austria

Ky rast ka të bëjë me një kontest të paraqitur në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve ICSID, në bazë të Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Republikës së Austrisë dhe Republikës së Kroacisë për Promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve, e cila hyri në fuqi në 1 nëntor 1999 dhe Konventa për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve midis Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të Tjera, e cila hyri në fuqi në 14 Tetor 1966 (Konventa ICSID). Paditësit janë Georg Gavrilović (paditësi i parë) një person fizik me shtetësi të Republikës së Austrisë dhe Gavrilović d.o.o. (paditësi i dytë), një kompani me përgjegjësi të kufizuar në Republikën e Kroacisë. Më 26 nëntor 2012, ICSID pranoi një kërkesë për arbitrazh të datës 16 nëntor 2012 nga Georg Gavrilović dhe Gavrilović d.o.o. kundër Republikës së Kroacisë. Më 21 Dhjetor 2012, Sekretari i Përgjithshëm i ICSID ka regjistruar kërkesën, siç plotësohet, në përputhje me nenin 36 alineja 3 të Konventës ICSID dhe ka njoftuar palët për regjistrimin. Në njoftimin e regjistrimit, sekretari i përgjithshëm ka ftuar palët për të formuar një gjykatë arbitrazhi sa më shpejt të jetë e mundur në përputhje me nenet 37 - 40 të Konventës ICSID.

Detajet e investimit

Pronësim dhe funksionim i një fabrike për përpunimin e mishit; pronësim i tokës bujqësore dhe kullotja e bagëtive në Kroaci.

Përmbledhje e kontestit

Pretendimet që vijnë nga kontesti rreth tokës bujqësore ¹⁰⁴dhe kullotëse për biznesin e përpunimit të mishit të investitorit në Kroaci, që çuan në çështje gjyqësore të pasuksesshme për Gavrilovic dhe kompaninë e tij si dhe shpronësimin e mëvonshëm ligjor të tokave dhe pronave të tij tregtare.

Me përbërje gjyqësore, kryetari i gjykatës Pryles, M. C.arbitri i zgjedhur nga paditësi Alexandrov, S. A, arbitri tjetër i zgjedhur nga i padituri Scherer, M. i zëvendësuar me Thomas, J. C, gjatë shqyrtimit të rastit gjykata e arbitrazhit ka konstatuar shkelje të marrëveshjes si: shpronësim i drejtëpërdrejtë dhe janë konstatuar shkelje të tjera si: mohim i drejtësisë. Ky rast është vendosur në favor të investitorit më datë 26 Qershor 2018. Shuma e kompensimit e pretenduar nga investitori ka qenë 198.20 milion euro ose 231.80 milion dollarë. Është shpërblyer nga gjykata me 20,20 milion hrk ose 3,20 milion dollarë amerikan¹⁰⁵.

¹⁰⁴“cujus est solum, ejus est usque ad coelum”...“kujt i takon toka, atij i takon e gjitha deri në qiell”

¹⁰⁵Linku I rastit të plotë: <https://icsid.worldbank.org/cases/case-database/case-detail?CaseNo=ARB/12/39>.

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Të gjithë ata të cilët jetojnë në Maqedoninë e Veriut janë të vetëdijshëm rreth situatave aktuale të vendit, tash e sa vite kur në Maqedoninë e Veriut bëhen përpjekje për të zbatuar reforma në gjyqësor, arbitrazhi si mënyrë alternative e zgjidhjes së kontesteve, në të cilën arbitri dëgjon të dy palët në kontest dhe sjell vendim të detyrueshëm, mund të konsiderohet një nga mënyrat e zgjidhjes së kontesteve më një siguri juridike me të lartë kundrejt zgjidhjes burokratike të kontesteve. Nga ana tjetër procedura e mediacionit si një procedurë më moderne e cila zbatimin më të madhë e kishte kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shtetet e Evropës, është një mënyrë tjetër e zgjidhjes alternative të kontesteve, në të cilën mediatori ndërmjetëson në kontestin e të dy palëve. Mediacioni duhet të shihet si një nga mënyrat bashkëkohore edhe në vendin tonë duke mundësuar që palët të arrijnë zgjidhjen e kontestit në afat rekord, në mënyrë diskrete dhe natyrisht me kosto më të ulët.

Në këtë hulumtim tentuam të krahasojmë të gjitha mënyrat e zgjidhjes së kontesteve, në rrugë gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, konkretisht: mediacionin, arbitrazhin dhe arbitrazhin ndërkombëtar. Edhe pse sado që u munduam që gjatë hulumtimit për shtetin e Maqedonisë së Veriut të nxjerrim në pah përparësit e saja në botën e investimeve, vetëm e vetëm të shikojmë ardhmërin në mënyrë optimiste, por është e pamundur të mos jem edhe realist për sa u përket aktualiteteve që e karakterizojnë këtë shtet. Maqedonia e Veriut, një shtet me “tiran qeverisës” është më se e qartë se vuan nga institucionet e dobëta qeveritare. Përfshirë funksionimin e gjykatave, ku për një kontest do të konsiderohesh i barabartë ligjërisht dhe do të kesh mundësi të kërkuash të drejtën tënde, vetëm në qoftë se je një nga “favoritët qeveritar” apo një nga “favoritët financiar”. Që do të thotë se aq sa politika e jashtme mundohet të promovojë investimet për vendin, po aq politika e brendshme mundohet të korruptojë çdo institucion.

Pa mos u përmirësuar në dobësitë e saja aktuale Maqedonia e Veriut, sa do që të përpiqet të harmonizojë legjislacionet me BE-në, nuk do të ketë ndonjë sukses.

Ja dhe disa nga rekomandimet e autores, për sa u përket kontesteve investuese:

- ✓ Krijimi i një qendre bashkëpunuese në mes avokatëve profesionistë; arbitrave; mediatorëve; juristëve; ekspertëve, të cilët do të shërbenin për dhënjen e këshillave dhe qasjeve të duhura në raste të kontesteve, duke i udhëzuar palët se çfarë procedure të ndjekin, por edhe cila mënyrë e zgjidhjes së kontesteve do tu përshtatej për kontestin e tyre;
- ✓ Përpjekje të vazhdueshme nga ana e shtetit për të promovuar efikasitetin, transparencën dhe barazinë në procedurat e zgjidhjes së kontesteve;
- ✓ Promovim dhe avancim i procedurës së mediacionit, që do të bënte lehtësimin e gjykatave në një numër të konsiderueshëm kontestesh investuese;
- ✓ *Krahas Invest North Macedonia* - Agjensionit zyrtarë qeveritarë i cili është vetëm përgjegjës për tërheqjen dhe zhvillimin e investimeve të huaja, do të ishte më se i nevojshëm dhe i drejtë, krijimi i një platforme tjetër, e cila do të mundësonte digjitalizimin e çështjeve për kontestet investuese.

LITERATURA

- A. Ilazi, *Ndikimi i imazhit të shtetit në tërheqjen e investimeve të huaja direkte- Rasti i Maqedonisë*. Tetovë, Univerziteti i Ejl, 2017.
- A. Jashari, *Aspekti Juridik i Investimeve të Huaja Direkte në Shtetet në Tranzicion*, Tetovë, Univerziteti i Ejl, 2007.
- A. Jashari, *E drejta afariste (kontraktore)*, Tetovë, Univerziteti i Ejl, 2016.
- A. Јаневски, З, Т. Камиловска, *Граѓанско процесно право*. Кн1, Парнично право, Скопје, Св. Климент Охридски. 2009.
- B. FLOREA, *Mediation as an Efficient Way of Saving Public Money*. *Juridical Current* 21, no. 1 (January 2018): 78–87.
<https://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&db=a9h&AN=128932506&site=ehost-live>.
- Convention Established, *Multilateral Investment Guarante Agency*, 2010. Retrieved 28 December 2019 from:
[https://www.miga.org/sites/default/files/archive/Documents/MIGA%20Convention%20\(April%202018\).pdf](https://www.miga.org/sites/default/files/archive/Documents/MIGA%20Convention%20(April%202018).pdf).
- D. Franck, Susan, Anne van Aaken, James Freda, Chris Guthrie, and Jeffrey J. Rachlinski. “Inside the Arbitrator’s Mind.” *Emory Law Journal* 66, no. 5 (September 2017): 1115–73.
<https://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&db=a9h&AN=123988472&site=ehost-live>.
- F. S., Mosten, Using Mediation Stories to Improve the Teaching of Conflict Resolution, 2013. *Cardozo Law Review*, 34(6), 2455–2473.
- G. B., Born, *International Commercial Arbitration*. s.l.: Kluwer Law International, 2009.
- G. Măgureanu, Considerations on the Historical Development of Arbitration and New Tendencies in the Development of National and International Arbitration. 2016, *Juridical Current*, 15(1), 123–135. Retrieved from:
<https://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&db=a9h&AN=74447918&site=ehost-live/>.
- G. R, Delaume, *Foreign Sovereign Immunity: Impact on Arbitration*. 1983, *Arbitration Journal*, 38(2), 34–47. Retrieved 29 December 2019 from:
<https://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&db=buh&AN=8665939&site=ehost-live>.
- ICSID Convention Regulation And Rules, 2006. Retrieved 02 Janar 2020 from:
<https://icsid.worldbank.org/en/Documents/icsiddocs/ICSID%20Convention%20English.pdf>.
- J. HÖRNER, , M. MASSIMO, & S. FRANCESCO, “Mediation and Peace.” *Review of Economic Studies* 82, no. 4 (October 2015): 1483–1501. doi:10.1093/restud/rdv022.

- Ligji për gjykatat, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.58/2006.
- Ligji për investime të huaja, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 17/2004
- Ligji për ndërmjetësim , “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”nr.114/2009
- Ligji për procedurë kontestimore, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.79/2005
- Ligji për punë devizore, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 49/2001.
- M. A, Forere, “New Developments in International Investment Law: A Need for a Multilateral Investment Treaty?” *Potchefstroom Electronic Law Journal* 21 (January 2018): 1–43. doi:10.17159/1727-3781/2018/v21i0a3282.
- M. J., Hetemi, *Arbitrazhi*, Prishtinë, 2015.
- M. L., Moses, *The Principles and Practice of International Commercial, Arbitration*. s.l.: Cambridge University Press, 2008.
- M. Wendy, M. Lawry, *Arbitral Institutions and the Enforcement of Climate Change Obligations for the Benefit of All Stakeholders: The Role of ICSID*, 2019. *ICSID Review: Foreign Investment Law Journal* 34, no. 1 : 1–31. doi:10.1093/icsidreview/siy019.
- Mediation of Investor-State Conflicts. *Harvard Law Review*, 127(8), 2543–2564. 2014.
- Multilateral Investment Guarantee Agency. Retrieved 26 December from: <https://www.miga.org/our-impact>.
- O. Miljenić, Full Protection and Security Standard in International Investment Law. 2019, *Pravni Vjesnik*, 35(3/4), 35–61. <https://doi.org/10.25234/pv/8128>
- Operational Policies, MIGA, (January 6, 2015). Retrieved 02 Janar 2020 from: <https://www.miga.org/sites/default/files/archive/Documents/Operations-Policies.pdf>.
- Q. Jija, “OUR GLOBAL VILLAGE: Prospects for Globalization and National Borders” Massachusetts institute of technology, 2011, Retrieved 25 December 2019 from:http://web.mit.edu/lipoff/www/hapr/winter01_development/globalization.pdf
- R. Dolzer, Ch. Schreuer, *Principles of International Investment Law*. Oxford University Press, 2008.
- R. Muçaj, International Arbitration as a Prerequisite in Today’s Global Economy, 2015 *Proceedings of the Multidisciplinary Academic Conference*, 291–298. Retrieved from: <https://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&db=a9h&AN=111482203&site=ehost-live> .
- S. Luttrell, *Testing the ICSID Framework for Arbitrator Challenges*, 2016. *ICSID Review: Foreign Investment Law Journal*, 31(3), 597–621. <https://doi.org/10.1093/icsidreview/siw023>
- Toena, *Fjalor i shqipes së sotme*. Tiranë, 2002.
- W. Kumberg, J. Lack, & M. Leathes, Enabling Early Settlement in Investor-State Arbitration: The Time to Introduce Mediation Has Come, 2014, *ICSID Review: Foreign Investment Law Journal*, 29(1), 133–141. <https://doi.org/10.1093/icsidreview/sit045>

- W. Miles, & M. Lawry-White, *Arbitral Institutions and the Enforcement of Climate Change Obligations for the Benefit of all Stakeholders: The Role of ICSID*, 2019. *ICSID Review: Foreign Investment Law Journal*, 34(1), 1–31. <https://doi.org/10.1093/icsidreview/siy019>
- Z. Douglas, *The international Law of Investment Claims*, Cambridge University Press, 2009.

Literatura online:

- International Centre for Settlement of Investment Disputes <https://icsid.worldbank.org/en/>.
- Investment Policy Hub <https://investmentpolicyhub.unctad.org/>.
- United Nations Conference on Trade and Development <https://unctad.org/> .
- International Centre for Dispute Resolution <https://icdr.org>.
- Multilateral Investment Guarantee Agency <https://www.miga.org>.
- Organisation for Economic Co-operation and Development <https://www.oecd.org>.
- International Finance Corporation <https://www.ifc.org/>.
- Foreign Direct Investments <http://www.fdi.gov.cn/> .
- United Nation Confercion on Trade and Development https://unctad.org/en/Docs/edmmisc232add38_en.pdf.
- International Court of Arbitration <https://iccwbo.org/content/uploads/sites/3/2017/01/ICC-2017-Arbitration-and-2014-Mediation-Rules-english-version.pdf.pdf>.
- Litigation & Dispute Resolution <https://www.globallegalinsights.com/practice-areas/litigation-and-dispute-resolution-laws-and-regulations>.
- OECD, *Benchmark Definition of Foreign Direct Investment*, Fourth Edition, 2008 <https://www.oecd.org/daf/inv/investmentstatisticsandanalysis/40193734.pdf>.
- Invesmten climate statements <https://www.state.gov/reports/2020-investment-climate-statements/north-macedonia/>.